In different study, when acne localises primarily on the face, it has a greater effect on psychological functioning. When it is on the back or the chest, because it can be covered with clothing, it causes less distress. It was reported that after recovery, patients that had acne localized on the face experienced significant positive changes in anxiety or depression, while patients with acne localized on the body experienced less degree of change in relation with these symptoms [10][11]. In our study most of the patients had facial acne localization, however, there wasn't a significant relationship between acne localization and symptoms of anxiety.

In our study there was no significant correlation between the symptoms of anxiety, age, gender, marital status, education and employment in the comparison between the two study groups (control group and the group of patients). But in the patient group a significant link was observed between symptoms of anxiety with age and civil status, in which only the 26-35 age group and single status proved significant. Some studies report that anxiety is not related to age and gender [4][6] [12], but several other studies report that is evident in women [9][10] [11].

CONCLUSIONS

Our study showed that acne vulgaris can be a source of significant of anxiety symptoms. Symptoms of anxiety according to our study are not affected by the gravity of

the disease, which means that we can not use the clinical features of the disease as a basis to assess the psychological state of patients, when it comes to symptoms of anxiety. We observed a positive correlation of symptoms of anxiety in relation to the patients age (over 26 years old) and single status of patients with acne vulgaris. Other factors included in the study had no impact on symptoms of anxiety.

REFERENCAT

1. Hanna, Shannon; Sharma, Jasdeep; Klotz, Jennifer. (2003). Acne vulgaris: More than skin deep. Retrieved March 21, 2009 from <http://dermatology.cdlib.org/93/commentary/acne/hanna.html>, abstract.↑
2. Kern, Daniel W. (2008). Adult acne. Retrieved March 26, 2009 from <http://www.acne.org/adult-acne.html>↑
3. Lasek. (1998). Comment, ¶4.↑
4. Wu SF, Kinder BN, Trunnell TN, Fulton JE. Role of anxiety and anger in acne patients: A relationship with the severity of the disorder. *J Am Acad Dermatol.* 1988;18:325-32. [PubMed]
5. Pearl A, Arroll B, Lello J, Birchall NM. The impact of acne: A study of adolescent's Attitudes, Perception and Knowledge. *N Z Med J.* 1998;111:269-71. [PubMed]
6. Grahame V, Dick DC, Morton CM, Watkins O, Power KG. The psychological correlates of treatment efficacy in acne. *Dermatol Psychosom.* 2002;3:119-25.
7. Yazici K, Baz K, Yazici AE, Köktürk A, Tot S, Demirseren D, et al. Disease -specific Quality of life is associated with anxiety and depression in patients with acne. *J Eur Acad Dermatol Venereol.* 2004;18:435-9. [PubMed]
8. Cotterill JA, Cunliffe WJ. Suicide in dermatological patients and psoriasis. *Br J Dermatol.* 1997;137:246-50. [PubMed]
9. Niemeier V, Kupfer J, Demmelbauer-Ebner M, Stangier U, Effendy I, Gieler U. Coping with acne vulgaris: Evaluation of the chronic skin disorder questionnaire in patients with acne. *Dermatology.* 1998;196:108-15. [PubMed]
10. Kellett SC, Gawkrödger DJ. The psychological and emotional impact of acne and the effect of treatment with isotretinoin. *Br J Dermatol.* 1999;140:273-82. [PubMed]
11. Rubinow DR, Peck GL, Squillace K et al (1987) Reduced anxiety and depression in cystic acne patients after successful treatment with oral isotretinoin. *J Am Acad Dermatol,* 17:25-32.
12. Aktan S, Ozmen E, Sanli B. Anxiety, depression and nature of acne vulgaris in adolescents. *Int J Dermatol.* 2000;39:354-7. [PubMed]
13. Tadinac M, Jokić Begić N, Hromatko I, Kotrulja L, Lauri-Korajlija A. Kronična bolest, depresivnost i anksioznost. *Socijalna psihijatrija.* 2006;34:169-74.
14. Lovibond, S.H. & Lovibond, P.f. (1995). *Manual for the Depression anxiety Stress Scales.* (2nd Ed) Sydney: Psychology Foundation

LIDHJA E SIMPTOMAVE TË ANKTHIT ME AKNE VULGARIS

Refatllari B.¹, Kuneshka L.², Lufi A.³, Canaj F.⁴, Pipero P.⁵

¹ Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë

² Departamenti i Statistikës, Fakulteti i Mjekësisë

³ Spitali Ushtarak Qëndror Universitar

⁴ Universiteti i Sporteve të Tiranës

⁵ Qendra Spitalore Universitare

ABSTRAKTI

Hyrje: Akne vulgaris ka qenë e lidhur me proceset psikiatrike dhe psikologjike dhe ajo është një nga shkaktarët kryesorë të ankthit në adoleshentët dhe adultët.

Qëllimi i studimit: Të vlerësojë lidhjen ndërmjet simptomave të ankthit dhe pacientëve me Akne Vulgaris, në lidhje me gravitetin e sëmundjes, lokalizimin e saj dhe të dhënave sociodemografike

Materiali dhe Metoda: U ndërmor një studim transversal cross-sectional gjatë periudhës janar 2010 – shtator 2011. Në studim u përfshinë 360 pacientë me akne vulgaris dhe 289 individë të shëndetshëm, të dy sekseve, të moshës 18-35 vjeç. Për vlerësimin e simptomave të ankthit është përdorur pyetësi DASS.

Rezultatet: Pacientët me akne patën nivel më të lartë të simptomave të ankthit, krahasuar me kontrollin ($P < 0.05$). Simptomat e ankthit në grupin e pacientëve nuk u ndikuan prej gravitetit të aknes, lokalizimit të saj, gjinisë, punësimit dhe arsimimit ($P > 0.05$). U vu re një lidhje sinjifikante e simptomave të ankthit me statusin martesor (beqarët) dhe moshën e pacientëve (26-35 vjeç). $P < 0.05$.

Konkluzion: Ka një lidhje të fortë të simptomave të ankthit me akne vulgaris, por simptomat e ankthit nuk ndikohen prej karakteristikave klinike të sëmundjes.

Fjalë kyçe: akne vulgaris, ankth, simptomat, pyetësi.

CISTEKTOMIA VAGINALE NËPËRMJET KULDOTOMISË

VAGINAL CYSTECTOMY THROUGH CULDOTOMY

Haxhihyseni A.¹, Haxhihyseni D.¹, Prifti M.¹

¹Spitali Rajonal Durrës, Albania

Autori për korespondencë e-mail: arben_haxhihyseni@yahoo.com

Medicus 2014, Vol. 19 (3): 459 -466

ABSTRAKTI

Hyrje: Teknika kirurgjikale e cistektomisë transvaginale është teknikë e re në Shqipëri e aplikuar për herë të parë në Maternitetin e Durrësit në vitin 2007.

Objektivi: studimi i realizueshmërisë së cistektomisë ovariale transvaginale, sigurisë së kuldotosisë dhe prezantimi i avantazheve të saj në pacientë të përzgjedhur me masa ovariale cistike jo malinje me madhësi të ndryshme.

Materiali dhe metodat: Të gjitha rastet u realizuan në gra në moshën e aktivitetit seksual. 20 prej tyre kishin diagnozën cist ovarial, 3 me diagnozë cist ovarial magna, dhe 6 me cist ovarial i torsionuar. Nëpërmjet kuldotosisë u arrit cisti dhe u punktua, pasi u zbraz u tërhoq në vaginë dhe u krye cistektomia tipike- enukleimi i kapsulës së cistit. U suturua ovari dhe u sigurua hemostaza. U suturua kuldotomia.

Rrezultatet: Madhësia mesatare e cistit ishte 68 mm. Koha operative mesatare ishte 29 min (14-38). Ditë qëndrimi në spital ishte 2 ditë (1-3). Nuk kishte asnjë rast me konvertim, asnjë rast me hemotransfuzion. Sasia mesatare e hemoragjisë intraoperative ishte 150 cc. 1 paciente kishte temperaturë deri 38 gradë celsius për 2 ditë, e cila u dominua me antibioterapi orale që vazhdoi 5 ditë.

Diskutim: kjo teknikë operatore ka avantazhe ndaj cistektomisë laparoskopike dhe padyshim ndaj asaj laparotomike por nuk ka vendin që meriton sepse shumica e gjinekologëve nuk kanë eksperiencë në kirurgjinë vaginale.

Konkluzioni: cistektomia vaginale nëpërmjet kuldotosisë në raste të përzgjedhura është teknikë operatore e sigurtë, e saktë dhe alternativë e shkëlqyer e laparotomisë dhe laparoskopisë.

Fjalë kyç: Transvaginal cystectomy, culdotomy, cystectomy

HYRJE

Historiku: Njerëzimi vazhdimisht është përpjekur që të paksojë pasojat e kirurgjisë laparotomike dhe një nga mundësitë është kirurgjia vaginale. Kirurgjia vaginale është teknikë kirurgjikale shumë më e hershme se laparoscopia. Kjo kirurgji është përdorur që në lashtësi për histerektominë vaginale. Një nga hapat e histerektomisë vaginale është dhe Kuldotomia.

Kuldotomia është një prerje transversale në fornixin posterior vaginal në nivelin e cul-de-sac (kavitetit të Douglasit) dhe realizon hyrjen direkt në kavitetin peritoneal pelvik. Kolpotomia e vetme, jo si hap i histerektomisë vaginale, është përshkruar për herë të parë në 1835 dhe është përdorur për të drenuar një abses

tubo-ovarial nga Hofmeister e Peleton [1]. Në 1894, Kelly [2] raportoi 10 raste të barrës ektopike dhe kështu ishte i pari që sugjeroi përdorimin e kuldotosisë, kolpotomisë si një rrugë për trajtimin e patollogjive adneksiale.

Vazhdimi i përpjekjeve njerëzore për minimizimin e pasojave të laparotomisë u kurorëzua me futjen në praktikën kirurgjikale të laparoskopisë, si teknikë kirurgjikale mini-invazive, dhe më pas të laparoskopisë me një portë hyrëse dhe laparoskopisë robotike. Këto zhvillime revolucionarizuan praktikën kirurgjikale dhe tani këto metoda janë futur në rutinën kirurgjikale me shumë sukses për trajtimin kirurgjikal të një sërë patollogjive siolecistektomia, ooforektomia, cistektomia, histerektomia në pacientë të përzgjedhur.

Kuldoskopia u përdor për herë të parë nga Dimitri Oscarovich Ott [3 në 1901. Ai futi një endoskop në kavitetin abdominal nëpërmjet një shpimi në fornixin posterior për egzaminimin vizual të viscerave femrore. Dimitri ishte gjinekolog nga St Petersburgu. Ai u ndoq nga Decker dhe Cherry në 1944.

Kuldotomia u bë popullore në vitet 1970, por meqë laparoskopia u pranua më gjërësisht, kuldotomia u la mënjanë megjithë meritat e saj. Sidoqoftë, në vitet e fundit, interesi për eksplorimin e teknikave akoma më pak invazive rivlerësoi kirurgjinë vaginale nga kirurgët gjinekologë por dhe nga kirurgët e përgjithshëm. Kirurgët gjinekologë nëpërmjet kuldotomisë kryejnë salpingektomi, cistektomi, ooforektomi, miomektomi dhe histerektomi [4-16], ndërsa kirurgët e përgjithshëm e përdorin kuldotominë gjatë laparoskopisë [17-21] për të nxjerrë nga kaviteti abdominal masa të mëdha, me qëllim që të mos i nxjerrin duke prerë paretin abdominal.

Siguria dhe efikasiteti i kuldotomisë çuan që kohët e fundit kuldotomia të paraqesë një interes më të madh, duke u përdorur tek NOTES [22, 23]. Kjo teknikë ka potencialin të shmangë komplikacionet që vijnë nga prerja abdominale [24, 25]. Raportimi i parë për kolecistektominë transvaginale humane, të kryer gjatë histerektomisë vaginale u publikua në 2003 nga Tsin dhe bashkp [26], ndërsa Marescaux dhe bashkp [27] raportoi në 2007 të parën kolecistektomi transvaginale të kryer tek njeriu.

Kuldotomia, shmang komplikacionet që ka prerja abdominale (laparotomia), si infeksioni i plagës abdominale dhe formimi i hernies së paretit abdominal, pakëson dhimbjet postoperative dhe pakson mundësinë e krijimit të aderencave peritoneale, ul ditëqëndrimin spitalor dhe kohën e rekonvaleshencës, përmirëson morbiditetin e përgjithshëm dhe kozmetik më shumë se laparoskopia, pakson traumat kirurgjikale dhe humbjen e gjakut, stresin neuroendokrin, dhimbjet postoperative dhe kohën e qëndrimit intrahospitalor (ka kostoeftivitet të shkëlqyer).

Siç përshkruhet dhe në literaturë kuldotomia ka vështirësi teknike për tu realizuar prandaj shumica e gjinekologëve nuk e aplikojnë. Por eksperinca e gjerë në kirurgjinë vaginale dhe kirurgjinë e dyshemesë pelvike krijon një bazë të fuqishme dhe eksperiençë të mjaftueshme për realizimin e kësaj teknike operate me saktësi dhe profesionalizëm. Rruga vaginale e cistektomisë ka rezultate shumë të mira për pacientet

sepse kjo teknikë plotëson kriteret e teknikave mini-invasive por njëkohësisht ka shpenzime më të ulta se çdo teknikë tjetër operate që realizon cistektominë

Duke parë interesin e sotëm për kuldotominë, qëllimi i këtij studimi është që të raportohet eksperienca e shërbimit tonë gjinekologjik në efikasitetin dhe sigurinë e kuldotomisë në një grup pacientesh me theksimin e veçantë në cistektominë transvaginal si model.

MATERIALI DHE METODAT

Në studimin tonë u shqyrtuan 29 rastet që kryen cistektomi transvaginale ovariale nëpërmjet kuldotomisë ose kolpotomisë posteriore. Teknika operate është e thjeshtë për tu realizuar kur operatori ka eksperiençë të gjerë në kirurgjinë vaginale, kërkon vetëm instrumenta kirurgjikale që ndodhen në të gjitha kompletet e operacionit të sallave kirurgjikale gjinekologjike të Shqipërisë. Instrumentat kryesore që përdoren janë, valvul gjinekologjike vaginale, divarikator vaginal, klampe anatomike me gjatësi mesatare përafërsisht 6 copë, myzo me dy ose katër dhëmbë, Terie' rreth 8 copë, një divarikator vaginal të gjatë për ekspozimin e adnekseve uterine, solucion fiziologjik 20 cc në shiringë sterile 20 cc me lidokainë 5 cc dhe adrenalinë 0.1%.



Fig 1. Instrumentat operate që përdoren në kirurgjinë vaginale

Anestezia më e përshtatëshme, e përdorur për realizimin e kësaj teknike operate, është anestezia spinale. Por me kërkesën e pacientes ose kur ka kundraindikacione për përdorimin e anestezisë spinale përdoret dhe anestezia gjenerale me intubim. Nga 29 raste gjithsej, u përdor anestezia spinale në 18 raste dhe anestezia gjenerale me intubim në 5 raste. Asnjë rast nuk çfaqti komplikacione nga anestezia. Pasi vendoset pacientja në pozicion Trendelenburg, dezinfektohen organet genitale të jashtme sipas procedurës standarte. Solucioni dezinfektues i përdorur është povidon jod 100 mg/ml e quajtur betadinë, e cila disponohet në sallat tona operate.

Dezinfektohet vagina dhe vendoset valvula vaginale e madhe. Injektohet solucion i pregatitur si më sipër në

forniksin posterior për të dominuar hemoragjinë gjatë kuldotomisë. Bëhet kolpotomia posteriore 1 deri 2 cm nën vendin e bashkimit të ligamenteve sakrouterine. Pritet mukoza vaginale rreth 3-4 cm, kapet peritoneumi i kavititetit të Douglasit- cul-de-sac posterior dhe pritët. Në këtë mënyrë arrihet kaviteti peritoneal. Kjo është teknika kuldotomike me dy faza. Kaviteti peritoneal arrihet dhe me një prerje të vetme, të njëkohëshme, të vaginës dhe peritoneumit. Mendohet që teknika e parë jep më shumë hemoragji [7, 8], sepse ndan paretin e vaginës nga peritoneumi, dhe hemoragjia vjen pikërisht nga kjo shtresë e hapur.

Vendoset një valvulë gjinekologjike në kaviteten e Douglasit dhe futet një garzë e gjatë e njomur me solucion fiziologjik. Hiqet valvula normale dhe vendoset një valvulë e gjatë (Fig 1) për të realizuar ekspozimin e cistit. Duke u orientuar nga ekografia paraprake identifikohet cisti, punktohet me një shiringë me age të gjatë dhe aspirohet sa më shumë likid që të jetë e mundur [23], me qëllim që të zvogëlohet madhësia e cistit ovarial, në rastet kur ai është i madh (zakonisht më i madh se 5 cm). Pasi zvogëlohet cisti, kapet ai me abortcang të drejtë e të gjatë dhe tërhiqet për tu ekspozuar në vaginë. Në tre rastet kur cisti ovarial unikameral ishte më i madh se 8 cm, u aplikua punksoni transabdominal me age punksoni. Pasi aspirohej likidi cistik sa më shumë të ishte e mundur, vetë cisti flashkej dhe mundësohej kapja dhe ekspozimi vaginal i tij.

Pasi ekspozohet qartë, pritej indi ovarial mbi kapsul rreth 3 cm dhe çkolitej me tërheqje kapsula e cistit, gradualisht deri sa hiqej plotësisht e gjithë kapsula e cistit.



Fig. 2 Interventi i cistektomisë vaginale

	Kapje, tërheqje	Punktim direkt	Punktim transabd	Totali
Madh <5	7			7
Madh 5-7		12		12
Madh >7		7	1	8
Madh >9			2	2
	7	19	3	29

Fig. 3. Rritja madhsise cistit rrit mundsine e punksonit transabdominal.

Zgavra e mbetur pas heqjes së kapsulës së cistit zakonisht nuk gjakoste ose gjakoste shumë pak. Pritej pjesa e ovarit të ndodhur mbi kapsulën e cistit, por pritej ajo pjesë që ishte shumë e hollë dhe me probabilitet shumë të ulët për tu rigjeneruar. Suturohej me suturë 1-0 absorbabël ovari derisa të rivendosej integriteti indor ovarial. Sigurohej të mos kishte hemoragji, pritej sutura dhe lihej ovari i lirë në kaviteten peritoneal pasi kontrollohej dhe një herë për gjakosje. Në 3 raste kur u mendua se mund të kishte hemoragji pas mbylljes së kuldotomisë u la dren intraperitoneal për 6 orë.

Suturimi i kuldotomisë u realizua me dy teknika. Teknika e parë ishte suturimi kontinua i peritoneumit me suturë absorbabël 1-0. Pas peritonizimit suturohej kontinua me suturë 1-0 muri i vaginës. Me këtë teknikë u trajtuan 21 raste. Teknika e dytë u realizua duke suturuar kontinua në mënyrë të njëkohëshme peritoneumin dhe vaginën [24]. Pasi suturohej kuldotomia, kontrollohej për hemoragji. Hiqej valvula dhe vendosej një garzë e madhe në vaginë që shërbente për të kryer hemostazë të plagës operatore (kuldotomisë). Kjo garzë hiqej pas rreth 6 orësh pas operacionit.

Ne jemi të mendimit se aktivizimi sa më i hershëm i pacientes në periudhën postoperative ndihmon regjenerimin e shpejtë të plagës operatore dhe shkurton riaftësimin e pacientes për jetë normale. Prandaj pacientja ngrihej në këmbë dhe lëvizte në mënyrë aktive që 6 orë postoperator. Në të gjitha rastet në të cilat u aplikua anestezia spinale u la kateter vezikal deri në 6 orë pas interventit, pra deri sa përfundoi plotësisht efekti i anestezisë spinale. Në të gjitha rastet ku u aplikua anestezia gjenerale me intubim kateteri vezikal u hoq menjëherë pas interventit. Garza vaginale kompresive hiqej pas 6 orësh në të gjitha rastet. Pacientja zakonisht dilte nga spitali në darkë ose të nesërmen e ditës së interventit.



FIG 3a Cisti ovarial në vaginë FIG 3b Cistektomia FIG 3c- kapsula e cistit

Indikacionet e përzgjedhjes së rasteve për cistektomi vaginale: Ciste pa septume ose me një septum, me likid të pastër ekografikisht [1-4], me indikatorë tumorale negative [1] (CA 125, CEA DHE CE). Gjatë vizitës vaginale cisti duhet të ishte i lirë, i pafiksuar, me mungesë të endometrioizës sidomos asaj të kavitetit të Douglasit, mungesë të simptomave të SIP akut ose kronik që shkaktojnë aderencë pelvike retrouterine dhe adneksiale. Për të përjashtuar natyrën malinje të cistit na ndihmi dhe MRI [3]. Nga 29 rastet tona u mundësua MRI në 4 raste.

U konsideruan kundraindikacione: operacionet e mëparshme abdominale kirurgjikale kur gjatë vizitës vaginale konstatohej kufizim i lëvizjes së uterusit dhe adneksëve, SIP sidomos ai kronik, endometrioza sidomos ajo retrouterine dhe adneksiale, që gjatë vizitës vaginale të linin përshtypjen e egzistencës së aderencave.

RREZULTATET

Në 29 rastet e studimit tonë 13 raste dolën nga spitali ditën e operacionit pasdite, 12 paciente dolën nga spitali të nesërmen dhe vetëm 4 paciente dolën të pasnesërmen. Pacientet e fundit ishin nga fshati dhe mendonin se në banesë nuk kishin shërbimin shëndetsor të përshtatshëm për ditën e dytë postoperatorë.

Periudha postoperatorë: Kanalizimi intestinal postoperator ishte i hershëm. Pacienteve ju rekomandua

nga ana jonë të fillonin të pinin lëngje që 6 orë pas operacionit dhe të ushqeheshin 12 orë pas operacionit me dietë hidrike, supëra etj. Përsa i përket profilaksisë së një infeksioni të mundshëm postoperator, të gjitha rasteve ju aplikua antibiotik (cefazolinë) 2 gr 2 orë preoperator intramuskular. Në 28 raste kjo profilaksi ishte e mjaftueshme. Vetëm një rast kishte temperaturë deri 38.2 pasdite pas operacionit që zgjati vetëm një ditë dhe u trajtua me ampicilinë orale 1.5 gram në ditë për 5 ditë. Gjendja u dominua pa komplikacione të tjera. Kohëzgjatja mesatare e operacionit të cistektomisë vaginale ishte 22 minuta (14 deri 37). U konstatua një rast me hematomë (3 cm) të kuldotomisë që u trajtua në mënyrë konservative dhe u rezorbua pa ndërhyrje kirurgjikale.

Kuldotomia u realizua në të gjitha rastet pa vështirësi. Koha mesatare e kuldotomisë ishte 4 minuta (3 - 11). Përpara prerjes së vaginës, në vëndin e prerjes u injektua deri 4-5 cc solucion fiziologjik me 1% adrenalinë. Sipas eksperiencës tonë ky injektim ndihmon në paksimin e hemoragjisë nga kuldotomia dhe ndihmon në lehtësimin e prerjes. Prerja në fornixsin posterior të vaginës, për të realizuar kuldotominë, u bë 1-2 cm nën vëndin e bashkimit të ligamenteve sakrouterine që përgjithësisht janë të dukshme në fornixsin posterior. Prerja u realizua në 14 raste në dy hapa. Në hapin e parë u pre fillimisht pareti vaginal, në hapin e dytë u ekspozua dhe u pre peritoneumi. Në të gjitha rastet në momentin e prerjes së peritoneumit rrodhi një sasi e pakët likidi seroz, që ne e konsideruam dhe si shenjë e hyrjes në kavitetin peritoneal. Pasi u siguruam që u futëm në kavitetin peritoneal u vendos një valvul e gjatë e prodhuar posacërisht për këtë qëllim. Vërejtëm se në 21 nga 29 rastet kishte hemoragji në këndët e prerjes së kuldotomisë. Në të dy këndët u bë hemostazë me pincë bipolare.

Përcaktimi i pozicionit të cistit, ekspozimi, kapja e tij, tërheqja dhe ekspozimi në vaginë ishin pjesa më e veçantë e interventit [14 15 16]. Madhësitë e cisteve ishin nga 5 deri 13 cm. Prej tyre 3 raste me ciste nga 9-13 u punktuat dhe aspiruan transabdominal. Aspirimi i likidit të cistit zvogëloi madhësinë dhe e flashku atë, gjë që mundësoi kapjen e cistit dhe lejoi tërheqjen e tij në vaginë dhe ekspozimin për të realizuar cistektominë. Në të gjitha rastet u realizua cistektomia nëpërmjet heqjes së plotë të kapsulës së cistit. Për të realizuar këtë procedurë u përdor metoda me tërheqje (striping), çkollitje të kapsulës nga indi ovarial duke kapur kapsulën dhe me një mjet tjetër duke kapur indin ovarial dhe duke i tërhequr në anë të kundërta. Çkollitja u bë e plotë në të gjitha rastet.

Kur cistet ishin të vogla me dimensionin maksimal nga 5 deri 8 çkolitja e kapsulës nuk shkaktoi hemoragji që të detyronte suturimin e ovarit. Prandaj ovari nuk u suturua dhe u la që të cikatrizohej spontanisht (22 raste). Ndërsa kur ovari ishte i madh, u suturua me suture vikril 01 dhe u sigurua që nuk kishte hemoragji. Kuldonomia u suturua me një shtresë kontinua pa lënë dren intra-abdominal.

Sasia e gjakut të humbur gjatë operacionit ishte mesatarisht 130 cc (35 deri 270 cc). Kuldonomia dhe Cistektomia transvaginale me heqje të kapsulës së cistit u realizua në të gjitha rastet (realizueshmëria 100%). Nuk kishte asnjë konvertim të teknikës operatore. Mendojmë se mungesa e konvertimit ndodhi nga eksperiencia e gjatë e ekipit operator në kirurgjinë vaginale dhe nga përzgjedhja e kujdesëshme e rasteve.

Prej tyre, 21 kishin diagnozën cist ovarial i subtorsionuar, 5 me diagnozë cist ovarial magna, dhe 2 me cist ovarial i torsionuar. Në të gjitha rastet u përjashtua natyra kanceroze nëpërmjet analizave CA 125, CEA dhe CE. Në të gjitha rastet pacientet u ngritën në këmbë pas 6 orësh nga interventi. Ditë qëndrimi në spital ishte 2 ditë (1-3). Në 23 rastet e studimit tonë 13 raste dolën nga spitali ditën e operacionit pasdite, 7 paciente dolën nga spitali të nesërmen dhe vetëm 3 paciente dolën të pasnesërmen. Pacientet e fundit ishin nga fshati dhe mendonin se në banesë nuk kishin shërbimin shëndetsor të përshtatshëm për ditën e dytë postoperatore. Kanalizimi intestinal postoperator është i hershëm. Nuk kishte asnjë rast me hemotransfuzion. Sasia mesatare e hemoragjisë intraoperatore ishte 150 cc. 1 paciente kishte temperaturë deri 38 gradë celsius për 2 ditë, e cila u dominua me antibioterapi orale që vazhdoi 5 ditë. Në të gjitha rastet u krye dhe kuldonomia dhe cistektomia nëpërmjet enukleimit. Egzaminimi histologjik i cisteve u krye në 9 raste dhe rezultoi; 7 ciste ovariale, 1 endometriomë dhe 1 cistadenoma seroze.

DISKUTIM

Pacientet e reja me ciste beninje ovariale dëshirojnë procedura mini-invasive për përparësitë që ka procedura, por gjithashtu duan dhe mungesën e çdo plage operatore të dukshme. Cistektomia transvaginale i plotëson këto kërkesa plotësisht kur mjeku mund ta realizojë. Sidoqoftë, një studim i randomizuar raporton se rreth 30% e procedurave transvaginale duhet të konvertohen në laparotomi për shkak të vështirësive teknike [9]. Megjithatë mendimi ynë është se në rastet e përzgjedhura cistektomia vaginale kryhet në 100% të rasteve.

Cistektomia ovariale vaginale konsiston në kuldotominë dhe cistektominë dhe vështirësi teknike ka në secilin hap. Por është shumë e rëndësishme eksperiencia në kirurgjinë vaginale dhe pelvike. Duke patur parasysh se kirurgjia vaginale sot nuk ka vendin që meriton, kirurgët gjinekologë ekspertë janë të pakët, prandaj një pjesë e madhe e mjekëve kanë vështirësi në kirurgjinë vaginale bile edhe për të bërë kuldotominë. Ka autorë që mendojnë se kuldonomia kryhet në mënyrë intuitive (SagaËa).

Duke u bazuar në eksperiencën tonë, për kirurgët gjinekologë me eksperiencë në kirurgjinë vaginale kuldonomia nuk është intuitive dhe duhet gjithmonë të përfundojë në kavitatin e Douglasit kur bëhet nga një ekspert kirurg gjinekolog.

Në eksperiencën tonë ne përdorim kuldotominë si hap të parë dhe më pas punktuam cistin që në rastet e përzgjedhura saktë realizohet gjithmonë. Për ekspozimin e cisteve ovariale të mëdha ne përdorim një lugë-valvul të gjatë të prodhuar në mënyrë artizanale. Kjo valvul ose divarikator është kaq e gjatë sa ti afrohet promontoriumit, kaq e gjërë sa të lejojë hyrjen në kuldotomi, e prodhuar në mënyrë artizanale prej materiali inoksidabël. Ky divarikator lejon ekspozimin e cistit. Për afrimin e cistit me qëllim që ai të bëhet i shikueshëm nga kuldonomia u përdor dhe një manovër mbi paretin abdominal për të shtyrë cistin drejt vaginës.

Cisti ovarial është një patollogji e shpeshtë gjinekologjike. Hapi i parë në diagnostikimin e cistit ovarial është përjashtimi i natyrës malinje sepse në rastet kur cisti ovarial është me natyrë malinje ka një protokoll tjetër trajtimi që përjashton kuldotominë.

Vlerësimi klinik për kancerin e ovarit përfshin anamnezën familjare dhe mjeksore individuale, egzaminimin fizik dhe CA 125 e cila, në kombinim me ekografinë, përcakton indeksin e dyshimit [28, 29, 30, 31] dhe nëse ka dyshime për kancer ovarial, pacientja do drejtohet për tek gjinekologu onkolog. As rezultati i ekos dhe as CA-125 të vetme nuk janë të mjaftueshme për diagnostikim e Ca ovarit. CA-125 është e rritur në 90% të grave me kancer ovarial të avancuar por vetëm në 50% të atyre të diagnostikuara me kancer ovarial të stadit të parë. Përveç kësaj, rritja e CA-125 shoqëron shumë gjendje të tjera si barra, leiomioma, sëmundje të mëlçisë ose të veshkave, sëmundja pelvike kronike, endometrioza dhe tumoret ovariale beninje. Për arsye të kohës së shpejtë të dyfishimit të kancerit të ovarit, nëse imazhi [28, 29, 30] nuk karakterizon shpejt një lezion beninj ovarial, ose nëse indikatorët klinikë (e. g. CA-125 levels) ose faktorët e riskut (si anamneza familjare

ose markerat genetike) të bëjnë të mendosh për kancer, rekomandimi bashkëkohor është që lezioni duhet hequr më mirë se sa të ndiqet. Meqenëse indikatorët e mësipërm edhe në kombinim nuk janë specifik, heqja kirurgjikale rrit më shumë se tre herë mundësinë të heqë një masë beninje se sa një kancer.

Masat adneksiale rastësore përfaqsojnë një patollogji me ndryshueshmëri të madhe ku përfshihen cistet funksionale, sekuela të infeksioneve të mëparshme, endometrioza, neoplazmat beninje ose malinje dhe ato që fillojnë nga organet pelvike përreth. Qëllimi i imazherisë [28, 29, 30] është të diferencojë sëmundjet beninje nga malinje. Ekografia transvaginale është metoda e preferuar për vlerësimin fillestar. Zakonisht kombinohet me ekografinë abdominale, që mund të jetë e nevojshme për të dalluar të dy ovarët dhe mund të dallojë karakteristikat ndihmëse të malinjitetit si hidronefroza, asciti dhe likidi pleural.

Karakteristikat ekografike të një mase beninje janë një cist unilokular i thjeshtë me një pariet të hollë të lëmuar. Cistet komplekse me zona hiperekogenike tregojnë një dermoid, dhe cistet me përmbajtje ipoekogenike uniforme mund të bëjnë të mendosh për endometrioze. Ka leziona beninje që kur dyshohen me ekografi, shpesh i rekomandohet karakterizimi definitiv me MRI. Vlerësimi paraprak negativ ekografik për malinjitet është 98%. Karakteristikat që dyshojnë malinjitetin përfshijnë cistet komplekse.

Anamneza, dekursi i patollogjisë, vizita vaginale dhe egzaminimi ekografik konfirmuan që cistet ovariale të përfshira në studimin tonë ishin beninj. Në të dhënat ekografike për të përjashtuar mundësinë e një procesi malinj u shqyrtua forma e cistit, likidi i pastër, mungesa e septumeve të shumta dhe e masave polipoide në brendësi të cistit [1, 2, 3, 4]. Madhësia mesatare e cistit ovarial ishte 68 mm (45-106).

Në rutinën kirurgjikale gjinekologjike në Shqipëri për të realizuar cistektominë aplikohet laparotomia. Së fundi ka filluar të përdoret dhe cistektomia laparoskopike por në raste të rralla dhe kryesisht në Klinikat private. Në Maternitetin e Durrësit cistektomia laparoskopike përdoret në rutinë që nga viti 2007.

Një rrugë tjetër kirurgjikale për realizimin e cistektomisë është dhe kuldotomia. Cistektomia e realizuar nëpërmjet kuldotomisë quhet cistektomia transvaginale, cistektomia kuldotomike, cistektomia ovariale transvaginale. Cistektomia transvaginale është aplikuar për herë të parë

në Shqipëri në 2007 në Maternitetin e Durrësit, si dhe tubektomia vaginale dhe gravidanca tubare e trajtuar me tubektomi. Rruga vaginale e cistektomisë ovariale ka epërsi ndaj cistektomisë laparoskopike dhe epërsi të padiskutueshme ndaj cistektomisë laparotomike.

Për zvogëlimin e volumit të cisteve shumë të mëdha ne kemi përdorur dhe punktionin transabdominal në katër raste. Nëpërmjet tij arrihet flashkja e cistit, gjë që lejon nxjerrjen e cistit në vaginë për të mundësuar cistektominë. Kur cisti është i madh, afërsisht mbi 6-7 cm, veçanërisht në gratë me peshë trupore mesatare ose nën të, cisti palpohet nëpërmjet parietit abdominal kur gruaja nën efektin e anestezisë. Nëpërmjet dorës jodominante operatori mund ta afrojë cistin drejt kuldotomisë për të lehtësuar punktimin e cistit.

Mendojmë se cistektomia vaginale realizohet nga shumë pak kirurgë gjinekologë sepse ka vështirësi teknike prej mungesës së eksperiencës. Nëse për kualifikimin e gjinekologëve në laparoskopji-histeroskopji firmat prodhuese të pajisjeve dhe instrumentave laparoskopike investojnë shumë për trajnimin laparoskopik, për kirurgjinë vaginale nuk investon askush. Një rrol të rëndësishëm për përhapjen e teknikave vaginale ka luajtur dhe Shoqata e Endoskopisë Gjinekologjike nëpërmjet organizimit të kurseve trajnuese në Maternitetin e Durrësit.

KONKLUZION

Cistektomia ovariale transvaginale është një teknikë operatore e sigurtë për një ekip me eksperiencë në kirurgjinë vaginale dhe kur rastet përzgjidhen me kujdes. Nëpërmjet kësaj teknike realizohet enukleimi i saktë i cistit ovarial dhe suturimi i plotë i ovarit, kur është i nevojshëm. Cistektomia ovariale transvaginale është teknikë operatore me kosto minimale dhe duhet të jetë teknikë e përzgjedhur në Shqipëri, për nivelin ekonomik që kanë spitalet tona. Rekomandohet që të kualifikohen gjinekologët dhe duhet të propagandohet më shumë si intervent i përzgjedhur.

REFERENCAT

1. Vitale GC, Davis BR, Tran TC. The advancing art and science of endoscopy. *Am J Surg*. 2005;190:228-33.
2. Sauerland S, Lefering R, Neugebauer EA. Laparoscopic versus open surgery for suspected appendicitis. *Cochrane Database Syst Rev*. 2004;(4):CD001546. doi:10.1002/14651858. CD001546.pub3.

3. Flora ED, Wilson TG, Martin IJ, O'Rourke NA, Maddern GJ. A review of natural orifice transluminal endoscopic surgery (NOTES) for intra-abdominal surgery: experimental models, techniques, and applicability to the clinical setting. *Ann Surg.* 2008;247:583-602.
4. Newton J, McCormack J. Female sterilization: a review of methods, morbidity, failure rates and medicolegal aspects. *Contemp Rev Obstet Gynaecol.* 1990;2(3):176-182.
5. Abrao MS, Sagae UE, Gonzales M, Podgaec S, Dias JA, Jr. Treatment of rectosigmoid endometriosis by laparoscopically assisted vaginal rectosigmoidectomy. *Int J Gynaecol Obstet.* 2005;91(1):27-31.
6. Yoong W, Pillai R. Posterior colpotomy-a retrieval route for solid ovarian tumours. *BJOG.* 2009;116(3):465-466.
7. Ayhan A, Boynukalin K, Salman MC. Tubal ligation via posterior colpotomy. *Int J Gynaecol Obstet.* 2006;93(3):254-255.
8. Chang WH, Liu JY, Yeh YC, et al. Tubal ligation via colpotomy or laparoscopy: a retrospective comparative study. *Arch Gynecol Obstet.* 2011;283(4):805-808.
9. Faivre E, Surroca MM, Deffieux X, Pages F, Gervaise A, Fernandez H. Vaginal myomectomy: literature review. *J Minim Invasive Gynecol.* 2010;17(2):154-160.
10. Ferrari MM, Mezzopane R, Bulfoni A, et al. Surgical treatment of ovarian dermoid cysts: a comparison between laparoscopic and vaginal removal. *Eur J Obstet Gynecol Reprod Biol.* 2003; 109(1):88-91.
11. Hoffman MS, Lynch C, Lockhart J, Knapp R. Injury of the rectum during vaginal surgery. *Am J Obstet Gynecol.* 1999; 181(2):274-277.
12. Kondo W, Noda RW, Branco AW, Rangel M, Branco Filho AJ. Transvaginal endoscopic tubal sterilization. *J Laparoendosc Adv Surg Tech A.* 2009;19(1):59-61.
13. Massi GB, Savino L, Lena A, Susini T. Management of benign adnexal masses by vaginal route. *Front Biosci.* 1996; 1:g8-11.
14. Tanaka M, Sagawa T, Hashimoto M, et al. Ultrasound-guided culdotomy for vaginal ovarian cystectomy using a renal balloon dilator catheter. *Ultrasound Obstet Gynecol.* 2008;31(3):342-345.
15. Tsin DA, Colombero LT, Mahmood D, Padouvas J, Manolas P. Operative culdolaparoscopy: a new approach combining operative culdoscopy and minilaparoscopy. *J Am Assoc Gynecol Laparosc.* 2001;8(3):438-441.
16. Wang PH, Lee WL, Juang CM, Tsai WY, Chao HT, Yuan CC. Excision of mature teratoma using culdotomy, with and without laparoscopy: a prospective randomised trial. *BJOG.* 2001;108(1):91-94.
17. Delvaux G, Devroey P, De Waele B, Willems G. Transvaginal removal of gallbladders with large stones after laparoscopic cholecystectomy. *Surg Laparosc Endosc.* 1993;3(4): 307-309.
18. Gill IS, Cherullo EE, Meraney AM, Borsuk F, Murphy DP, Falcone T. Vaginal extraction of the intact specimen following laparoscopic radical nephrectomy. *J Urol.* 2002;167(1):238-241.
19. Pillai R, Yoong W. Posterior colpotomy revisited: a forgotten route for retrieving larger benign ovarian lesions following laparoscopic excision. *Arch Gynecol Obstet.* 2010; 281(4):609-611.
20. Sanchez JE, Rasheid SH, Krieger BR, Frattini JC, Marcet JE. Laparoscopic-assisted transvaginal approach for sigmoidectomy and rectocolpopexy. *JSLs.* 2009;13(2):217-220.
21. Dozois EJ, Larson DW, Dowdy SC, Poola VP, Holubar SD, Cima RR. Transvaginal colonic extraction following combined hysterectomy and laparoscopic total colectomy: a natural orifice approach. *Tech Coloproctol.* 2008;12(3):251-254.
22. Bessler M, Stevens PD, Milone L, Parikh M, Fowler D. Transvaginal laparoscopically assisted endoscopic cholecystectomy: a hybrid approach to natural orifice surgery. *Gastrointest Endosc.* 2007;66(6):1243-1245.
23. Tsin DA, Sequeria RJ, Giannikas G. Culdolaparoscopic cholecystectomy during vagin hysterectomy. *JSLs.* 2003;7(2):171-172.
24. Smorgick N, Barel O, Halperin R, Schneider D, Pansky M. Laparoscopic removal of adnexal cysts: is it possible to decrease inadvertent intraoperative rupture rate? *Am J Obstet Gynecol.* 2009;200:237.e1-237.e3.
25. McGee MF, Rosen MJ, Marks J, et al. Primer on natural orifice transluminal endoscopic surgery: building a new paradigm. *Surg Innov.* 2006;13:86-93.
26. Boni L, Benevento A, Rovera F, et al. Infective complications in laparoscopic surgery. *Surg Infect (Larchmt).* 2006;7(suppl 2):S109-S111.
27. Thele F, Zygmunt M, Glitsch A, Heidecke CD, Schreiber A. How do gynecologists feel about transvaginal NOTES surgery? *Endoscopy.* 2008;40:576-580.
28. Fishman, DA, Cohen, L, Blank, SV, Shulman, L, Singh, D, Bozorgi, K, Tamura, R, Timor-Tritsch, I and Schwartz, PE. (2005) The role of ultrasound evaluation in the de-

- tection of early-stage epithelial ovarian cancer. *Am J Obstet Gynecol* 192: 1214-21
29. Kinkel, K, Lu, Y, Mehdizade, A, Pelte, MF and Hricak, H. (2005) Indeterminate ovarian mass at US: incremental value of second imaging test for characterization--meta-analysis and Bayesian analysis. *Radiology* 236: 85-94
 30. Sohaib, SA, Mills, TD, Sahdev, A, Webb, JA, Vantrappen, PO, Jacobs, IJ and Reznek, RH. (2005) The role of magnetic resonance imaging and ultrasound in patients with adnexal masses. *Clin Radiol* 60: 340-8
 31. Yamashita, Y, Torashima, M, Hatanaka, Y, Harada, M, Higashida, Y, Takahashi, M, Mizutani, H, Tashiro, H, Iwamasa, J and Miyazaki, K. (1995) Adnexal masses: accuracy of characterization with transvaginal US and precontrast and postcontrast MR imaging. *Radiology* 194: 557-565

VAGINAL CYSTECTOMY THROUGH CULDOTOMY

Haxhihyseni A.¹, Haxhihyseni D.¹, Prifti M.¹

¹Regional Durrës Hospital, Albania

Corresponding author: e-mail: arben_haxhihyseni@yahoo.com

ABSTRACT

Background: Surgical technique of transvaginal cystectomy is a new technique in Albania, applied for the first time in Durres Hospital in 2007.

Objectives: To evaluate the technique of transvaginal ovarian cystectomy, the safety of culdotomy and presentation of its advantages at the selected patients that have cystic ovarian masses, not malignant, with different sizes.

Material and methods: All the cases were realized in women of sexual activity age. 20 of them were diagnosed with ovarian cyst, 3 of them with magna ovarian cyst and 6 women were diagnosed with torsioned ovarian cyst. The cyst was reached through, it was drilled, was partially emptied from liquid and pulled to vagina and was done a typical removal of cystic capsule. The ovary was sutured and there was no hemorrhage and suturation of culdotomy was done.

Results: Cystic average size was 68 mm. The average time of surgery was 29 minutes (14-38). Average stay in hospital was 2 days (1-3). There were no cases surgery technique conversion and no cases with hemotransfusion. The average quantity of hemorrhage during surgery was 150 cc. There was only one patient with high temperature up to 38°C for 2 days and it was dominated with oral antibiotherapy for 5 days.

Discussion: this surgical technique has a lot of advantages against laparoscopic cystectomy and no doubt against abdominal cystectomy, but it has not its merited place yet because most of the gynecologists do not have experience in vaginal surgery.

Conclusion: The vaginal cystectomy through culdotomy in the selected cases is a very safe and secure surgical technique and an excellent alternative of laparoscopic and laparotomic surgery.

Key words: Transvaginal cystectomy, culdotomy, cystectomy

REFLUKSI VEZIKOURETERAL, KORRELACIONET MIDIS EKOGRAFISE DHE CISTOURETROGRAFISE

VESICOURETERAL REFLUX, CORRELATIONS BETWEEN ULTRASOUND AND VOIDING CISTOURETROGRAPHY

Cela D.¹, Hidri B.², Shtiza D.³, Petrela E.⁴, Preza K.²

¹ Departamenti i Imazherisë, Fakulteti i Mjeksisë, QSUT

^{2,3} Departamenti Nefropediasisë, QSUT

⁴ Departamenti Epidemiologji-Statistikë, QSUT

Medicus 2014, Vol. 19 (3): 467 -473

ABSTRAKT

Qëllimi i studimit: Korrelimi të dhënave ekografike me cistouretrografi në miksonale në zbulimin e gradimit e refluksit vezikoureteral për shmangien e cistouretrografive të panevojshme te fëmijët.

Materiali dhe Metodologjia: U përfshinë në Studim 202 fëmijë shtruar në Spitalin Pediatrik, QSUT diagnostikuar me Infeksion i traktit urinar, e gjetje ekografike jonormale. Mosha 1muaj - 16 vjec, 121femra, 81 meshkuj, periudha kohore 2006 -2010. Cistouretrografia u krye pas ekzaminimit ekografik nën kontrollin e skopisë televizive. Për gradimin e refluksit u përdor sistemi internacional i gradimit radiologjik, grada 1-5.

Rezultatet: 48 raste rezultuan me refluks veziko-ureteral (Ntotal = 202) Rezultoi se ka lidhje të fuqishme sinjifikante, statistikisht të rëndësishme mes zgjerimit të ureterit në ekografi e prezencës së refluksit në cistouretrografi (k.korrelac. Kendal= 0.208, n=202, p= 0.003), Cikatriceve renale në ekografi e prezencës së refluksit në cistouretrografi (k. Korrelac. Kendal = 0,274, n=202, p < 0,001).

Nuk ka lidhje sinjifikante mes zgjerimit të sistemit pielokalicien, trashjes së paretit të vezikës urinare, në ekografi e prezencës së refluksit në cistouretrografi. Nuk ka diferencë statistikisht të rëndësishme në gjini me praninë e refluksit (p=0,057).

Konkluzioni: Prezenca e cikatriceve renale dhe zgjerimi i ureterit në ekografi, ka lidhje të fuqishme, statistikisht të rëndësishme me prezencën e refluksit veziko ureteral në cistouretrografi. Konkludojmë: Cistouretrografia duhet të indikohet si ekzaminim në të gjitha rastet e fëmijëve të diagnostikuar klinikisht me infeksion të traktit urinar kombinuar me gjetje ekografike të zgjerimit ureteral ose të cikatriceve renale.

Fjalet kyce: Refluksi veziko-ureteral, cistouretrografia, infeksioni i traktit urinar të fëmijët, ekografia renale.

HYRJE

Refluksi vezikoureteral përkufizohet si një rrjedhje retrograde e urinës nga vezika në ureter dhe traktin urinar të sipërm. (1) Në shumicën e rasteve ndodh si rezultat i një anomalie të maturimit primar të junktionit vezikoureteral. Në raste më të rralla mund të jetë sekondar nga anomali të tjera kongenitale siç është valvula e uretres posteriore ose duplikimi i plotë i traktit urinar. Shumica e pacientëve që zhvillojnë cikatrice renale pas infeksioneve të traktit urinar, në fëmijëri kanë refluks vezikoureteral dhe gradat e larta të refluksve vezikoureterale janë shoqëruar me mundësi të

mëdha për të zhvilluar cikatrice. Nefropatia e refluksit është përgjegjës për 30-50% të insuficencave renale në pacientët e pediasisë dhe 20% te adultët.

Procedura diagnostike e zakonshme për zbulimin e refluksit vezikoureteral është cistouretrografia mixionale.(2) Besueshmëria e këtij ekzaminimi varet nga graviteti i refluksit. Disa studime kanë demonstruar që vetëm grada e 4 dhe 5 e refluksit janë treguar me besueshmëri 100% në cistografi mixionale, sepse refluksi veziko ureteral mund të jetë intermitent dhe graviteti i tij mund të variojë në

sekuenca të ndryshme. Kufizim tjetër i rëndësishëm i cistoutrografisë miksionale është ekspozimi ndaj rrezatimit. Është vlerësuar që më shumë se 25% e rrezatimit me potencial për të prodhuar alteracione gjenetike të marra nga popullata pediatrike është lidhur me imazherinë e sistemit urinar, veçanërisht cistografinë miksionale.

Përdorimi për herë të parë i ekografisë në diagnozën e refluksit vezikoureteral u publikua në 1976.(3) Studimet e hershme treguan që ekografia nuk ishte një metode sensitive për diagnozën e refluksit veziko-ureteral. Sensitiviteti dhe specifikiteti i ulët i ekografisë B-mode dhe doppler për zbulimin e refluksit veziko-ureteral e ktheu vemëndjen tek ekografia me kontraste përforcuese të cilët duke u injektuar në vezikë si në cistografinë miksionale do të përmirësojnë zbulimin e refluksit vezikoureteral. Pas shumë përpjekjesh të pasukseshme u zbulua një suspension i galaktozës që njihet me emrin levovist i cili pati rezultate të shkëlqyera. (4)

QËLLIMI I STUDIMIT:

Të korrelohen të dhënat ekografisë me cistoutrografinë miksionale në zbulimin dhe gradimin e refluksit vezikoureteral me objektivin kryesor shmangien e kryerjes së cistografive të panevojshme.

MATERIALI DHE METODOLOGJIA

Ky është një studim kohort ku u përfshinë 202 fëmijë të shtruar pranë Spitalit Universitar Pediatrik, Tiranë, diagnostikuar me diagnozën klinike: Infeksion i traktit urinar, dhe gjetje ekografike jonormale. Mosha 1 muaj deri 16 vjec, prej tyre, 121 femra dhe 81 meshkuj, periudha kohore 2006 -2010.

Ekzaminimi bazë ekografik përfshin skanimin longitudinal dhe transversal të dy reneve dhe vezikës urinare.


Ekografia standarte e traktit urinar u realizua në pozicionin supin dhe prone. Vëmëndje e veçantë iu kushtua zbulimeve të vogla në regionin retrovezikal, junksionit vezikoureteral dhe çdo lloj zgjerimi të ureterëve. Për më tepër pelviset renale u skanuan me magnifikim maksimal.

Ekzaminimi ekografik u krye me frekuencat kryesore 3.5 ose 5mhz sondë sektoriale ose 7.5 mhz sondë lineare.

Cistoutrografia është kryer pas ekzaminimit ekografik në kontrollin e skopisë televizive duke treguar kujdes ndaj dozës rrezatuese. Pacientët u kateterizuan transuretral, dhe kateteri 5-8 F u bashkua me një sistem serum të vendosur 70cm mbi kokën e pacientit. Si lëndë kontrasti

u përdor urografia 60 dhe 76 dhe ultravist 300 e holluar me solucion fiziologjik. Për zbulimin e refluksit vëmëndja u përqëndrua sidomos në fazën miksionale. Për gradimin e refluksit u përdor Sistemi Internacional i Klasifikimit Të Refluksit Vezikoureteral Tek Fëmijët, (5) nga grada 1-5.

Klasifikimi Internacional i Refluksit Vezikoureteral



Gradimi i refluksit veziko-ureteral sipas Sistemit Internacional i Refluksit. Kjo skicë ilustron pesë gradë të refluksit veziko-ureteral.

Grada e parë (gr I) paraqet refluksin në një ureter jo i zgjeruar.

Grada e dytë (gr II) paraqet refluks në një ureter dhe sistem pielokalicien të padilatuar.

Grada e tretë (gr III) paraqet refluks në një ureter dhe sistem pielokalicien lehtësisht të dilatuar. Këndet e fornikeve dhe impresionet papilare mbeten akoma të qarta.

Grada e katërt (gr IV) paraqet refluks me një ureter tortuoz dhe sistem pielokalicien të zgjeruar.

Grada e pestë (gr V) paraqet refluks me një ureter tortuoz shumë të dilatuar dhe sistem pielokalicien shumë të dilatuar. Këndet e fornikeve dhe impresionet papilare janë të zhdukura.

Kriteret përjashtuese

U përjashtuan nga studimi, pacientët, të cilëve, nuk u vizualizoheshin mjaftueshëm në ekografi

një ose të dy veshkat (p.sh.skolioza e shprehur)

Nuk u përfshinë në studim pacientët, prindërit e të cilëve refuzuan të japin pëlqimin për kryerjen cistoutrografisë pas informimit të hollësishëm rreth ekzaminimit.

Mbledhja e të dhënave

Për secilin pacient u plotësua një kartelë tip, ku përshkruhen gjeneralitet, të dhënat dermografike, mosha dhe seksi, të dhënat klinike, anamneza, gjetjet ekografike, prania ose jo e sëmundjeve shoqëruese, përdorimi i medikamenteve, si më poshtë:

- Të përgjithshme: gjinia, mosha, vendbanimi, diagnoza klinike, sëmundje shoqëruese,

- Gjetjet e ekografisë: zgjerimi i ureterit, zgjerimi i sistemit pielokalicien, trashja e pareteve të vezikes urinare, cikatricet renale,
- Gjetjet e cistouretrografisë: grada e refluksit, anomalitë renale,

Përpara çdo ekzaminimi u mor pëlqimi i prindit pas informimit të hollësishëm, dhe u shpjeguan me kujdes detajet për procedurën e ekzaminimit të cistouretrografisë.

Të gjitha këto të dhëna së bashku me zbulimet e ekografisë dhe cistografisë u paraqiten në një tabelë excel. Prezenca e të dhënave ekografike dhe e refluksit shënohet me 1 dhe mungesa e tyre me 2.

REZULTATET

Nga totali i numrit të fëmijëve të ekzaminuar në studim, N= 202, 48 raste rezultuan me refluks veziko-ureteral. Prej tyre 47.8% e gjinisë femra dhe 52.2% e gjinisë meshkuj.


Të dhënat ekografike që u analizuan për korrelacionet me refluksin e evidentuar dhe me anë të cistouretrografisë ishin:

1. Dilatacioni i pelvisit renal
2. Dilatacioni i ureterit distal
3. Cikatricet renale
4. Trashje e pareteve të vezikës urinare

Ku u mor parasysh që prania e refluksit dhe gjetjet ekografike të izoluara të ishin homolaterale.

Sipas gradës së refluksit 9 raste gr.I ose 18.8%, 24 raste gr.II ose 50.0% , 8 raste gr.III, ose 16.7 % 4 raste gr.IV ose 8.3% dhe 3 raste gr.V, ose 6.3%, të paraqitura si më poshtë:

Refluksi vezikoureteral- Gradë



Valid	Frequency	Percent
grada I	9	18.8
grada II	24	50.0
grada III	8	16.7
grada IV	4	8.3
grada V	3	6.3
Total	48	100.0

Nga studimi rezultoi se ka një lidhje të fuqishme sinjifikante, statistikisht të rëndësishme midis zgjerimit të ureterit në ekografi dhe prezencës së refluksit në cistouretrografi (Tab. 1)

Tab.1

	Korrelacioni Kendall	Ureter / ECHO
Cistografi - eko	Koeficienti i korrelacionit	208 (**)
	Sinjifikanca	.003
	N	202

** korrelacioni është sinjifikant në nivelin 0.01 (2-tailed)

Koeficienti i korrelacionit të Kendal = 0.208, n = 202, p = 0.003.

Rezultoi se, ka një lidhje të fuqishme, statistikisht të rëndësishme, mes cikatriceve në ekografi dhe prezencës së refluksit në cistouretrografi (Tab.2)

Tab.2

	Korrelacioni Kendall	Cikatrice _ECHO
Cistografi eko	Koeficienti i korrelacionit	.274(**)
	Sinjifikanca.	< 0.001
	N	202

Koeficienti i korrelacionit të Kendal = 0,274, n = 202, p < 0,001

Nga ky studim rezultoi se: Nuk ka lidhje sinjifikante ndërmjet zgjerimit të sistemit pielokalicien në ekografi dhe prezencës së refluksit në cistouretrografi, (Tab.3)

Tab.3

	Korrelacioni Kendall	Kalice _ECHO
Cistografi eko	Koeficienti i korrelimit	-.043
	Sinjifikanca.	.539
	N	202

Nuk ka lidhje sinjifikante.

Rezultoi se nuk ka lidhje sinjifikante mes trashjes së paretit të vezikes urinare në ekografi dhe prezencës së refluksit në cistouretrografi. (Tab.4)

Tab. 4

	Korrelacioni Kendall	Paretet _ECHO
Cistografi eko	Koeficienti i Korrelacionit	.040
	Sinjifikanca	.567
	N	202

** korrelacioni është sinjifikant në nivelin 0.01 (2-tailed) Tab. 4

Nuk ka lidhje sinjifikante.

Gjithashtu nga studimi rezultoi se nuk ka diferencë statistikisht të rëndësishme në gjini lidhur me praninë e refluksit (p=0,057). (Tab 5)

- Shpërndarja sipas seksit. Korrelimi gjinia * cistografi_ECHO Korrelimi gjinia * prani_reflux

Tab.5

			prani_reflux		Total
			Jo	po	
Gjinia	F	numer	99	22	121
		% me prani_reflux	63.5%	47.8%	59.9%
	M	Numer	57	24	81
		% me prani_reflux	36.5%	52.2%	40.1%
Total		Numer	156	46	202
		% me prani_reflux	100.0%	100.0%	100.0%

Shihet se nuk ka difference statistikisht te rendesishme ne gjini lidhur me pranine e reluksit (p=0,057).



Duke qënë se grupi i marrë në studim, në lidhje me anomalitë shoqëruese të traktit urinar dhe grupit me sëmundje shoqëuese ishte në numër të vogël, korrelacioni statistikor midis tyre dhe prezencës së refluxit vezikoureteral doli josinjifikant, gjatë studimit. (Tab 6 dhe Tab7)

Nr = 26, per anomalite kongenitale, Nr = 39, per semundjet shoqeruese.

Tab 6-A ka lidhje sinjifikante refluxi me anomalitë renale? (korrelacionet)

	Korrelacioni Kendall	Anomalitë
prani_reflux	Koeficienti i korrelacionit	.032
	Sinjifikanca	.645
	N	202

Nuk ka lidhje sinjifikante

Tab 7-A ka lidhje me sëmundje shoqëruese.

	Korrelacioni Kendall	Semundje shoq
prani_reflux	Koeficienti i korrelacionit	-.026
	Sinjifikanca	.708
	N	202

Nuk ka lidhje sinjifikante

DISKUTIMI

Në klinikën pediatrike është bërë rutinë kërkësa për ekzaminimin e Cistouretrografisë për praninë ose jo të refluxit vezikoureteral në të gjitha rastet e pacientëve që paraqiten me diagnozën infeksion të traktit urinar. Nga literatura ka evidencë të plotë që dëshmon se nuk ka lidhje sinjifikante midis infeksionit të traktit urinar dhe pranisë së refluxit vezikoureteral të fëmijët. (6) Gjithashtu prevalenca e refluxit vezikoureteral te fëmijët pa infeksione të traktit urinar është pothuajse e barabartë me atë të fëmijëve me infeksione të traktit urinar. (7)

Cistouretrografia, kërkohej me insistim, veçanërisht, në rastet që shoqëroheshin me gjetje dhe të dhëna ekografike jo normale.

Duke iu referuar literaturës ndërkombëtare, Cistouretrografia është një procedurë shqetësuese dhe tepër stresante për fëmijën dhe prindin. Mund të përdoret metoda jofarmakologjike dhe farmakologjike sedatuese për të ulur ankthin, shqetësimin dhe axhitimin tek fëmijët (analgjezikë, anksiolitikë dhe amnezia). Sedatimi kërkon kosto, kohë si dhe duhen të merren parasysh problemet e sigurisë së pacientit (safety issues) (8)

Një nga risqet e tjera madhore është ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues me evidencë nga literatura. (9)

Vlera e perlllogaritur e dozë së rrezatimit (10 -12)

Pjesa e trupit ku kryhet imazheria	Doza Efektive (mSv)	Ekuvalenca me grafine me rreze X te kraharorit. (mSv)
Fëmija 5-vjeçar:		
Rrezatimi natyror i përvitshëm sipas Denver	3.5	175
2- shikime te gjoksit (kraharorit)	0.02	1
Grafi Anteriorposterior + lat abdomen	0.05	2.5
Cistoshintigrafia me tekneium 99 m	0.18	9
Cistouretrografia Miksionale	0.33	16
CT e kraharorit	3	150
CT e kokës	4	200
CT Abdomeni (barku)	5	250
Të Rritur (Adultë):	1.8-8.3	90-165
Grafi direkte renale	3	150
Urografi intravenoze		

Shqetësimi ynë klinik lindi si pasojë e këtyre kërkesave të shumta për ekzaminime të Cistouretrografisë (VCUG), te fëmijet e diagnostikuar me infeksion të traktit urinar, bazuar në risqet dhe komplikacionet që shoqëron këtë ekzaminim.

Për të arritur tek qëllimi kryesor i studimit për shmangjen e cistouretrografive të panevojshme, dhe nxjerrjen e

përfundimeve dhe rekomandimeve për indikacionet e cistouretrografisë, të fëmijët me infeksion të traktit urinar, u ngritën këto hipoteza në diskutim si më poshtë:

1. A ka lidhje sinjifikante midis dilatacionit të ureterit distal në ekografi dhe prezencës së refluksit vezikouretral në cistouretrografi? (fig.1)

Figura 1 Pamje imazherike



Zgjerimi i ureterit distal EKO

Refluks vezikoureteral
Cistouretrografi

Rezultoi se ka një lidhje të fuqishme sinjifikante, statistikisht të rëndësishme midis zgjerimit të ureterit në ekografi dhe prezencës së refluksit në cistouretrografi. (Tab1, Rezultate).

Gjetje kjo që korrespondon me studimet nga literatura ndërkombëtare ku rezulton lidhje sinjifikante midis zgjerimit të ureterit distal dhe refluksit të fëmijët. Theksohet se tek foshnjat zgjerimi i ureterit shoqërohet me gradë të lartë të refluksit dhe hidronefrozë. (13)

2. A ka lidhje sinjifikante ndërmjet cikatriceve renale në ekografi dhe prezencës së refluksit vezikouretral në cistouretrografi? (fig. 2)

Figura 2 Pamje imazherike



Cikatrice renale ne Eko

Refluks Vezikoureteral
ne Cistouretrografi

Rezultoi se ka një lidhje të fuqishme, statistikisht të rëndësishme, mes cikatriceve në ekografi dhe prezencës së refluksit në cistouretrografi (Tab. 2 Rezultate). Gjetje kjo që korrespondon me studimet nga literatura

ndërkombëtare. Evidenca radiologjike e cikatriceve renale është prezente në 30-60% e fëmijëve me refluks dhe refluksi është prezent në pothuajse të gjithë fëmijët

(97%) me cikatrice renale të theksuara (të rënda) (14)

3. A ka lidhje sinjifikante ndërmjet dilatacionit pelvik në ekografi dhe prezencës së refluksit vezikouretral në cistografi? (fig.3)

Figura 3 Pamje imazherike




Zgjerim pelvikaliceal në EKO

Rezultoi se nuk ka lidhje sinjifikante ndërmjet zgjerimit të sistemit pielokalicien në ekografi dhe prezencës së refluksit në cistouretrografi, (Tab.3 Rezultate) Gjetje kjo që korrespondon me studimet nga literatura ndërkombëtare, ku rezulton se nuk ka korrelacion sinjifikant midis gradës së zgjerimit të sistemit pielokalicien në ekografi dhe prezencës ose gradës së rëndësës së refluksit vezikouretral (15).

4. A ka lidhje sinjifikante ndërmjet trashjes së paretit të vezikës urinare në ekografi dhe prezencës së refluksit vezikourinar? (fig.4)

Figura 4 Pamje imazherike



Rezultoi se nuk ka lidhje sinjifikante mes trashjes së paretit të vezikës urinare në ekografi dhe prezencës së refluksit në cistouretrografi. (Tab. 4, Rezultate). Nga literatura ndërkombëtare ka studime ku trashjen e mureve të vezikës urinare e korrelojnë me refluksin vezikouretral, por në studimet e 10 vjecarëve të fundit janë botuar

publikime të cilat nuk e mbështesin këtë rezultat.(nuk ka lidhje sinjifikante me trashjen e pareteve dhe refluksit) (16)

Përsa u perket korrelacioneve midis sëmundjeve kongenitale dhe refluksit nga literatura ka studime të shumta të cilat mbështesin lidhjen sinjifikante midis tyre.(17)

Në grupin tonë të studimit nuk u arrit të shihej një korrelacion i tillë pasi numri i fëmijëve të marrë në studim me këto anomali ishte i vogël.

KONKLUZIONE

Ekografia B-mode dhe doppler mbetet një metodë me sensitivitet të ulët në zbulimin e refluksit vezikoureteral.

Cistouretrografia është ekzaminimi me sensitivitet dhe besueshmeri më të lartë në zbulimin e reflukseve vezikoureterale megjithatë nuk duhet harruar risku i lartë i rrezatimit të gonadeve me pasoja gjenetike.

Vetë infeksioni i traktit urinar nuk ka lidhje sinjifikante me prezencën e refluksit vezikoureteral, prandaj është e domosdoshme kombinimi me të dhënat ekografike për hartimin e një protokollit të saktë për indikacionet e cistouretrografisë.

Zgjerimi i ureterit distal ka lidhje sinjifikante të rëndësishme me prezencën e refluksit veziko ureteral. Po kështu prezenca e cikatriceve renale ka lidhje sinjifikante të rëndësishme me prezencën e refluksit veziko ureteral në cistouretrografi.

Cistosonografia ose ekografia me kontrast dhe MR-urografi duke iu referuar studimeve të huaja tenton ti afrohet rezultateve të cistouretrografisë duke mos përdorur rrezatim jonizues.

Rekomandojmë kryerjen e cistouretrografisë në rastet e fëmijëve me infeksion të traktit urinar shoqëruar kjo me gjetjet ekografike të zgjerimit të ureterit distal dhe/ose prezencës së cikatriceve renale.

LITERATURA

1. Caleb P Nelson, Marc Cendron et.al: Pediatric Vesico Ureteral Reflux June 24 2013 Medscape Radiology art /101/6439
2. Palmer BW, Ramji FG, Snyder CT, et al.: Voiding cystourethrogram; J Urol 2011 oct;186(sup 4)

3. Ellenbogen PH, Scheible FW, Talner LB, Leopold GR (1978) Sensitivity of gray scale ultrasound in detecting VUR
4. Rajko B. Kenda. Gregor Novijan. Anton Kenig. Sergej Hojker. Jure J Fettich: Echo- enhanced ultrasound voiding cystography in children: a new approach: Pediatr Nephrol (2000) 14:297-300
5. Lebowitz RL, Olbing H, Parkkulainen KV et al:International Reflux Study in Children, Pediatric Radiology 1985; 15: 105 -9.
6. Caleb P Nelson,Cendorn Marc at al.: Pediatric Vesico Urethral Reflux Clinical Presentation. Pub med Medscape Radiology article
7. Caffey's Pediatric Diagnostic Imaging Eleventh Edition page: 2339
8. David W.Herd. Anxiety in Children Undergoing VCUG: Sedation or No Sedation Advances in Urology 2008 artc. ID 498614
9. Kelly L. Stratton, John C. Pope at.al Implications of Ionizing Radiation in the Pediatric Urology Patient; The Journal of Urology Vol.183, 2137-2142 June 2010
10. Rice HE, Frush DP, Farmer D et al: Review of radiation risks from computed tomography: essentials' for the pediatric surgeon. J Pediatric Surg. 2007; 42: 603.
11. Brody AS, Frush DP, Huda W et al: Radiation risk to children from computed tomography. Pediatrics 2007; 120: 677.
12. Mettler FA Jr, Huda W, Yoshizumi TT et al: Effective doses in radiology and diagnostic nuclear medicine: a catalog. Radiology 2008; 248: 254.
13. Chang Hee Hong, Yong Jae Imat al : Journal of Pediatric Urology Vol.6, supplement 1,pg S-32, April 2010,
14. Rooks veronica; Lin c Eugene Vesicoureteral Reflux Imaging publMedscape 2013
15. Veronique Phan. Jeffry Traubici at al. : Vesicouretral reflux in infants with isolated antenatal hydronephrosis Pediatric Nephrology (2003) 18:1224 - 1228
16. Sillen .U : Blader disfunction and vesicoureteral reflux author. Advanced Urology Pub med 2008 : 815472
17. Caffey's Pediatric Diagnostic Imaging Eleventh Edition page 2343

VESICoureTERAL REFLUX, CORRELATIONS BETWEEN ULTRASOUND AND VOIDING CISTOURETROGRAPHY

Cela D.¹, Hidri B.², Shtiza D.³, Petrela E.⁴, Preza K.²

¹ Imaging Departament, Medical Faculty, HUCT

² Imaging Departament, Pediatric Hospital, HUCT

³ Nephropediatric Clinic, HUCT

⁴ Departament of Epidemiology-Statistic, HUCT

ABSTRACT

Purpose: Correlations between ultrasound and voiding cistouretrography in detection and grading of vesicoureteral reflux VUR in order to avoid the unnecessary cistouretrography in children.

Materials and methods: 202 children (1 month -16 years old), hospitalized in Pediatric Clinic in Tirana, were included in the study, diagnosed with urinary tract infection (UTI) with abnormal ultrasound findings, for the period 2006-2010. Voiding cistouretrography under fluoroscopy was done shortly after ultrasound examination, considering the risk of ionizing radiation exposure. The international system of radiographic grading of vesicoureteral reflux was used for reflux grading I to V.

Results: Reflux was detected in 48 children. There was a statistically significant relationship between distal ureter dilatation in ultrasound and presence of VUR in voiding cistouretrography (Kendal coef.correlacion= 0.208, n=202, p= 0.003) There was a statistically significant relationship between renal scars and presence of VUR.(Kendal coef. correlacion = 0,274, n=202, p < 0,001) There was no statistically significant relationship between renal pelvis dilatation, thickening of urinary bladder wall, and the presence of VUR and gender related to the presence of reflux (p=0,057).

Conclusions: There is a statistically significant relationship between renal scars , distal urethral dilatation in US with the presence of VUR in VCUG.

Based in our study results we conclude that VCUG should be indicated in all cases of children with UTI associated with renal scars and / or distal urethral dilatation in US.

Key words: vesicoureteral reflux VUR, urinary tract infection (UTI), renal ultrasound (US)

DISA NGA VEÇORITË EPIDEMIOLOGJIKE TË SËMUNDJEVE CEREBROVASKULARE TE PACIENTËT E TRAJTUAR NË KLINIKËN E NEUROLOGJISË NË QENDRËN KINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVË NË PRISHTINË

SOME EPIDEMIOLOGIC FEATURES OF CEREBROVASCULAR DISEASE IN PATIENTS TREATED IN THE CLINIC OF NEUROLOGY AT THE UNIVERSITY CLINICAL CENTER OF KOSOVA IN PRISTINA

Shatri N.¹, Bara P.², Blyta A.¹, Dakaj N.¹, Vranica S.¹, Isaku E.¹, Zeqiraj K.¹, Jashari F.¹

¹ Qendra klinike Universitare e Kosovës - Klinika e Neurologjisë

² Qendra Spitalore Universitare "Nëna Terezë" Tiranë, Shqipëri

Medicus 2014, Vol. 19 (3): 474 -479

ABSTRAKT

Hyrje: Sëmundjet cerebrovaskulare (SCV) janë çrregullimi më i shpeshtë neurologjik dhe shkaktari më i shpeshtë i paaftësive.

Studimi ka për qëllim të krahasoj shpeshtësinë e paraqitjes së SCV në raport me sëmundjet tjera neurologjike, shpërndarjen e SCV sipas moshës dhe gjinisë, raportin në mes të llojeve të SCV si dhe të analizoj mortalitetin hospitalor, në klinikën e Neurologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2010.

Metodat: Është analizuar në mënyrë retrospektive dokumentacioni mjekësor i 2384 pacientëve të shtrirë në klinikën e Neurologjisë (QKUK) në periudhën kohore janar-dhjetor 2010. Diagnoza e SCV është vendosur në bazë të ekzaminimit klinik dhe ekzaminimit neuroimazherik të trurit (tomografia e kompjuterizuar dhe rezonanca magnetike).

Rezultatet: Nga 2384 pacientë të hospitalizuar, 1115 (47%) kanë qenë me SCV dhe 1269 (53%) me sëmundje tjera neurologjike. Nga 1115 pacientë me SCV, 534 (48%) kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe 581 (52%) të gjinisë femërore. Me inafekt iskemik kanë qenë 872 (78%), me atak transitor ishemic 37 (3.3%), me hemorragji intracerebrale 152 (14%) dhe 24 (2%) me hemorragji subarahnoidale. Mortaliteti i përgjithshëm hospitalor ka qenë 11% apo 255 pacientë. Vdekshmëria më e lartë ka qenë në mesin e pacientëve me SCV, gjithsej 89% apo 228 pacientë.

Konkluzion: SCV janë shkaktar i parë i morbiditetit dhe mortalitetit në klinikën e Neurologjisë krahasuar me të gjitha sëmundjet tjera neurologjike.

Fjalët kyçe: insultet cerebrovaskulare, iskemia cerebrale, hemorragjia intracerebrale, tomografia e kompjuterizuar.

HYRJE

Sëmundjet cerebrovaskulare (SCV) karakterizohen me manifestim akut të simptomatologjisë klinike dhe paraqesin çrregullimet më të shpeshta neurologjike (1). Në krahasim me sëmundjet tjera, SCV janë shkaktari më i shpeshtë i vdekjeve dhe paaftësisve të rënda dhe komplekse të rriturit (2, 3).

Në vitin 1990 SCV, në vendet e zhvilluara, kanë qenë shkaktari i dytë i vdekjeve pas sëmundjeve iskemike të zemrës kurse në vendet në zhvillim kanë qenë shkaktari i tretë i vdekjeve, pas infeksioneve të rrugëve respiratore të poshtme, dhe sëmundjeve iskemike të zemrës (4). Në vit, nga SCV, në botë sëmurën rreth 16 milion njerëz

(5), derisa gjatë jetës 1 në 6 njerëz do të përjetoj insult cerebrovaskular (6,7). Rreth 5 milionë të sëmurë me SCV vdesin, kurse 5 milionë të tjerë mbesin me shkallë të ndryshme të aftësisë së kufizuar (8). Në vendet më pak të zhvilluara, rreth 2/3 e vdekjeve janë si pasojë e SCV (9).

Sipas të dhënave të COD 2008 (Deaths by age, sex and cause for the year 2008) nga sëmundjet cerebrovaskulare në vitin 2008 në botë kanë vdekur rreth 6.2 milion njerëz (11% e të gjitha vdekjeve) duke qenë kështu shkaktari i dytë i vdekshmërisë pas sëmundjeve iskemike të zemrës (10). Të dhënat nga raporti COD 2008 po ashtu tregojnë se SCV edhe në Evropë janë shkaktari i dytë i vdekjes, pas sëmundjeve iskemike të zemrës, duke shkaktuar rreth 14% të të gjitha vdekjeve (11).

Edhe studimet më të reja e mbështesin faktin se insultet cerebrovaskulare janë shkaktari i dytë më i shpeshtë i vdekjeve në Evropë, duke shkaktuar 1.1 milion vdekje në vit (12).

Incidenca e SCV është e ndryshme në vende të ndryshme të botës, në Evropën perëndimore sillet 100-200, Evropën lindore 300-400 raste në 100.000 banorë (13).

Studimet epidemiologjike të realizuara në 5 deceniet e fundit në vendet Perëndimore kanë evidentuar një ulje të konsiderueshme të shkallës së SCV (14). Incidencë më e ulët është regjistruar në Zvicër dhe SHBA (15).

Në vendet e Evropës lindore dhe në republikat e ish Bashkimit Sovjetik, si dhe në vendet e pazhvilluara incidenca dhe mortaliteti i SCV ende janë në rritje (16). Në vendet e regjionit, psh. në Serbi nga SCV sëmurën rreth 23 000 njerëz në vit (17). Përkundër mungesës së hulumtimeve dhe statistikave të mirëfillta mund të supozohet se edhe në Kosovë SCV janë në rritje.

Duke pasur parasysh se incidenca dhe prevalenca e SCV në Kosovë nuk është e njohur, qëllimi i punimit ka qenë që të krahasohet shpeshtësia e paraqitjes së SCV me sëmundjet tjera neurologjike te pacientët e shtrirë në klinikën e Neurologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2010, të theksohen disa nga veçoritë epidemiologjike të SCV si shpërndarja sipas moshës dhe gjinisë, raporti mes llojeve të ndryshme të SCV dhe të analizoj mortalitetin hospitalor gjatë kësaj periudhe kohore.

METODAT


Studimi është bazuar në analizimin retrospektiv të dokumentacionit mjekësor të 2384 pacientëve me sëmundje të ndryshme neurologjike, të shtrirë në klinikën

e Neurologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë në periudhën kohore janar-dhjetor 2010. Te të gjithë pacientët me sëmundje cerebrovaskular diagnoza është vendosur në bazë të ekzaminimit klinik dhe ekzaminimit neuroimazherik të trurit si tomografia e kompjuterizuar e trurit (TKT) apo rezonanca magnetike e trurit (MRI). Për vlerësimin e sinjifikancës statistikore nga testet statistikore është përdorur chi-square test-i (niveli i sinjifikancës $p < 0.05$).

REZULTATET

Në periudhën kohore janar-dhjetor 2010 në klinikën e Neurologjisë në QKUK, në Prishtinë kanë qenë të hospitalizuar 2384 pacientë. Nga 2384 pacientë 1115 (47%) kanë qenë me sëmundje cerebrovaskulare (SCV) dhe 1269 (53%) me sëmundje tjera neurologjike (grafiku/graph 1).

Grafiku/graph 1. Paraqitja e numrit të pacientëve të hospitalizuar në klinikën e neurologjisë në periudhën kohore janar-dhjetor 2010 (presentation of number of patients hospitalized in clinic of Neurology in period January-December 2010)




Numri më i madh i pacientëve me SCV ka qenë i gjinisë femrore, 581 (52%), krahasuar me 534 (48%) të gjinisë mashkullore.

Nga numri i përgjithshëm i pacientëve me SCV, 872 (78%) kanë qenë me insult iskemik, 37 (3.3%) me atak transitor iskemik (ATI), 152 (14%) me hemorragji intracerebrale (HIC) dhe 24 (2%) me hemorragji subarahnoidale (HSA). Te 30 (2.7%) pacientë tjerë lloji i sëmundjes cerebrovaskular nuk ka mundur të përcaktohet për shkak se ata kanë vdekur para se ka mundur tu bëhet ekzaminimi me imazheri (TKT apo MRI e trurit) dhe te këta pacientë

dignoza e sëmundjes cerebrovaskulare është vendosur në bazë të kriterëve klinike (grafiku/graph 2).

Grafiku/graph 2. Paraqitja grafike e llojit të insulteve cerebrovaskulare e shprehur në përqindje (Graphic presentation of the type of cerebrovascular accidents expressed in percentage)



Përpos te rastet e diagnostikuara me atak transitor iskemik (ATI), ku numri më i madh i rasteve ka qenë i gjinisë mashkullore gjithsejt 22 (59%) pacientë, në të gjitha

llojet tjera të SCV gjinia femërore ka qenë predominuese (tabela 1):

Tabela 1. Shpërndarja e llojit të insulteve cerebrovaskulare sipas gjinisë

Table 1. Distribution of cerebrovascular disease type by gender.

Lloji i insultit cerebrovaskular (type of cerebrovascular disease)	Gjinia (Gender)					
	Mashkuj (Male)		Femra (Femal)		Total	
	N	%	N	%	N	%
ICV ishemike (Ischemic stroke)	412	47	460	53	872	78
Atak transitor ishemik (Transient ischemic attack)	22	59	15	41	37	3.3
Hemorragji intracerebrale (Intracerebral hemorrhage)	75	49	77	51	152	14
Hemorragji subarachoidale (Subarachnoidal hemorrhage)	11	46	13	54	24	2
ICV të papërcaktuara (Undetermined strokes)	13	43	17	57	30	2.7
Total	533	48	582	52	1115	100

Megjithëse numri më i madh i pacientëve me sëmundje cerebrovaskulare kanë qenë të gjinisë femërore, nuk ka pasur ndryshim sinjifikant statistikor në mes të gjinive (chi-square statistika 2.2971 kurse P-vlera=0.513, për $p < 0.05$)

Results - chi-square test

	Mashkuj	Femra				Row Totals
Insulte truore iskemike	412 (417.92) [0.08]	460 (454.08) [0.08]				872
Hemorragji intracerebrale	75 (72.85) [0.06]	77 (79.15) [0.06]				152
ATI	22 (17.73) [1.03]	15 (19.27) [0.95]				37
HSA	11 (11.50) [0.02]	13 (12.50) [0.02]				24
Column Totals	520	565				1085 (Grand Total)

Pjesa më e madhe e pacientëve me insult trunor iskemik kanë qenë të moshës 60-79 vjeç, gjithsejt 574 pacientë apo 66%. Prej tyre 298 apo 52% femra dhe 276 apo 48% mashkuj. Një dallim i theksuar në përqindje sa i përket paraqitjes së insultit iskemik trunor në raport me gjininë është regjistruar te moshat më të reja, grup moshë 40-50 vjeç, ku 55% e pacientëve janë të gjinisë femërore krahasuar me 45% të gjinisë mashkullore tabela 2.

Tabela 2. ICV iskemike: Shpërndarja sipas grup moshave dhe gjinisë.

Table 2. Ischemic strokes: Distribution according to age and gender.

Moshë e pacientëve (Age of patients)	Gjinia (Gender)					
	Mashkuj (male)		Femra (femal)		Total	
	N	%	N	%	N	%
80 + vjeç (age of 80 and above)	54	45	65	55	119	13.9
70-79 vjeç (age 70-79)	136	43	177	57	313	36
60-69 vjeç (age 60-69)	140	54	121	46	261	30
50-59 vjeç (age 50-59)	61	49	64	51	125	14
40-49 vjeç (age 40-49)	15	45	18	55	33	3.8
30-39 vjeç (age 30-39)	5	29	12	71	17	1.9
20-29 vjeç (age 20-29)	0	0	2	100	2	0.2
10-19 vjeç (age 10-19)	1	50	1	50	2	0.2
TOTAL	412	47%	460	53%	872	100%

Pjesa më e madhe e pacientëve me HIC kanë qenë të moshës 60-80 vjeç, gjithsejt 114 pacientë apo 75%, prej tyre femra 59 (52%) dhe mashkuj 55 (48%). Te grup moshë 40-60 vjeç numri më i madh i pacientëve me HIC kanë qenë meshkuj, 18 (58%) krahasuar me 13 (42%) femra nga gjithsejt 31 pacientë të kësaj grupmoshe tabela 3.


Tabela 3. Hemorragjia intracerebrale: Prevalence sipas grup moshave dhe gjinisë.

Table 3. Intracerebral hemorrhage: Prevalence according to age and gender.

Moshë e pacientëve (Age of patients)	Gjinia (Gender)					
	Mashkuj (male)		Femra (femal)		Total	
	N	%	N	%	N	%
80+ vjeç (age of 80 and above)	7	30	16	70	23	15
70-79 vjeç (age 70-79)	22	49	23	51	45	30
60-69 vjeç (age 60-69)	26	57	20	43	46	30
50-59 vjeç (age 50-59)	14	58	10	42	24	16
40-49 vjeç (age 40-49)	4	57	3	43	7	4.6
30-39 vjeç (age 30-39)	2	67	1	33	3	1.9
20-29 vjeç (age 20-29)	0	0	3	100	3	1.9
10-19 vjeç (age 10-19)	0	0	1	100	1	0.6
TOTAL	75	49%	77	51%	152	100%

Mortaliteti i përgjithshëm hospitalor gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2010 ka qenë rreth 11% (255 pacientë të vdekur nga gjithsejt 2384 të hospitalizuar) dhe më i larti ka qenë mes pacientëve me sëmundje cerebrovaskulare, gjithsejt 228 (89%) pacientë të vdekur (grafiku/graph 3).

Grafiku/graph 3. Mortaliteti hospitalor janar dhjetor 2010 (Hospital mortality January-December (2010))



Nga 228 vdekje, si pasojë e sëmundjeve cerebrovaskulare, 141 (62%) pacientë kanë vdekur nga pasojat insultit cerebrovaskular iskemike, 54 (24%) nga hemorragjia intracerebrale, 3 (1%) kanë vdekur nga hemorragjia subarahnoidale, kurse te 30 (13%) pacientë tjerë nuk ka mundur të përcaktohet lloji i insultit cerebrovaskular për shkak se vdekja e tyre ka ndodhur pa u realizuar ekzaminimet imazherike (CT dhe/apo MRI e trurit).

Në mesin e pacientëve me SCV vdekshëria ka qenë rreth 20% dhe atë më e larta te pacientë me HIC 35.5%, te ICV ishemike 16% dhe te pacientë me HAS 12.5%.

Numri më i madh i pacientëve të vdekur me SCV kanë qenë të moshës 70-79 vjeç, gjithsejt 134 apo 59%, prej të cilëve 54 apo 40% kanë qenë të gjinisë mashkullore kurse 80 apo 60% të gjinisë femrore.

DISKUTIM:

SCV ndodhen në vendin e 3të në botë, si shkaktarë i mortalitetit, pas sëmundjeve ishemike të zemrës dhe sëmundjeve malinje (18). Rreth 0.9 % e të gjitha hospitalizimeve janë nga SCV deri sa rreth 30% të hospitalizimeve në klinikat e Neurologjisë janë si pasojë e SCV (19,20). Përqindja e hospitalizimeve nga SCV në klinikën e Neurologjisë gjatë periudhës janar-dhjetor 2010 ka qenë rreth 47%, që është më e madhe se ajo e raportuar në studimet e lartpërmendura, duke qenë kështu bindshëm shkaktari më i shpeshtë i hospitalizimeve në klinikën tonë.

Sipas shumicës së punimeve epideiologjike dhe të dhënave nga literatura, incidenca e SCV është më e lartë te mashkujt se te femrat, derisa mortaliteti është më i lartë te femrat (62% e mortalitetit të përgjithshëm nga SCV) (21,22). Në studimin tonë me përjashtim të atakut transitor iskemik (ATI), ku numri më i madh i rasteve ka qenë i gjinisë mashkullore, te të gjitha llojet tjera të sëmundjeve cerebrovaskulare numri më i madh i të sëmurëve kanë qenë femra, por nuk ka pasur ndryshim sinjifikant statistikor në mes të gjinive ($P = 0.513$, për $p < 0.05$). Rezultate të ngjashme janë fituar edhe në një studim të bërë në Serbi (23). Mortalite më i lartë nga SCV në mesin e pacientëve femra është gjetur edhe në studimin tonë, ku 60% e pacientëve të vdekur nga SCV kanë qenë të gjinisë femërore. Studimi ynë ka zbuluar se rreth 76% e të sëmurëve me SCV janë të moshës së shtyer, 60-80 vjeç, dhe se rreth 52% e të sëmurëve të kësaj moshe kanë qenë të gjinisë femërore, derisa 48% të gjinisë mashkullore. Të

dhëna të ngjashme japin edhe studimet e bëra viteve të fundit në SHBA, ku numri më i madh i të sëmurëve me SCV në moshat e shtyera ka qenë i gjinisë femërore (24). Nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve me SCV, rreth 24%, kanë qenë të moshës më të rinjë se 60 vjeç, rezultate këto që janë në përputhje me të dhënat e OBSH.

Sa i përket lloji të SCV, numri më i madh i pacientëve me SCV kanë qenë të diagnostikuar me ICV ishemik, gjithsej 872 raste deri sa 152 raste kanë qenë të diagnostikuar me hemorragji intracerebrale. Raporti në mes insulteve cerebrovaskulare ishemike dhe hemorragji intracerebrale, i gjetur në studimin tonë është 85% për insulte cerebrovaskulare ishemike ndaj 15% për hemorragji intracerebrale. Këto të gjetura janë të përafërta me të gjeturat e studimit të kryer në Kroaci (25).

Gjatë analizimit të rezultateve të vdekshmërisë së përgjithshme në klinikën e Neurologjisë gjatë vitit 2010, është vërtetuar se numri më i madh i vdekjeve është regjistruar në mesin e të sëmurëve me SCV duke paraqitur rreth 89% të të gjitha vdekje të ndodhura. Numri më i madh i pacientëve të vdekur me SCV kanë qenë të moshës 70-79 vjeç, gjithsej 134 apo 59%, prej të cilëve 54 apo 40% kanë qenë të gjinisë mashkullore kurse 80 apo 60% të gjinisë femërore. Në mesin e llojeve të SCV vdekshmëria më e lartë ka qenë te pacientët me HIC (35, 5%) krahasuar me llojet tjera të SCV; me ICV ishemike (16%) dhe HSA (12.5%). Të dhëna për vdekshmëri më të lartë, me një përqindje dukshëm më të lartë se ajo e fituar nga studimi ynë, janë fituar edhe në një studim të bërë në Bosnjë dhe Hercegovinë (26).

KONKLUZION

SCV janë shkaktari i parë i morbiditetit dhe mortalitetit në klinikën e Neurologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Prevalenca e ICV ishemike është më e shpeshtë se ajo e hemorragji intracerebrale derisa vdekshmëria më e lartë është në mesin e pacientëve me hemorragji intracerebrale. Përfaqësimi i gjinisë femërore ka qenë më i madh në të gjitha llojet e sëmundjeve cerebrovaskulare, me përjashtim të atakut transitor ishemik.

REFERENCAT

1. Demaerschalk BM. Diagnosis and management of stroke (brain attack). *Sem Neurol* 2003; 23:241-51.
2. Di Carlo A. Human and economic burden of stroke. *Age and Ageing* 2009; 38: 4-5 doi: 10.1093/ageing/afn282.
3. Adamson J., Beswick, A. and Ebrahim, S. Stroke and

Disability *Journal of Stroke and Cerebrovascular Diseases* 2004 vol 13, No. 4 2004 P171-177.

4. Murray LJC, Lopez AD. The global burden of disease: a comprehensive assessment of mortality and disability from diseases, injuries, and risk factors in 1990 projected to 2020. Cambridge, Mass: Harvard School of Public Health; 1996.
5. Strong K, Mathers C, Bonita R. Preventing stroke: saving lives around the world. *Lancet Neurol* 2007; 6: 182-7.
6. World Stroke Organization Facts and figures about stroke <http://www.world-stroke.org/for-patients/facts-and-figures-about-stroke> (accessed 31/10/12)
7. Seshadri, S. and Wolf, P.A. Lifetime risk of stroke and dementia: current concepts, and estimates from the Framingham Study *Lancet Neurology* vol 6, issue 12 P1106-1114 December 2007.
8. WHO The Atlas of heart disease and stroke section 15: Global burden of stroke <http://www.who.int/cardiovascular-diseases/en/cvdatlas15burdenstroke.pdf> Mackay J and Mensah G 2004.
9. Warlow C, Sudlow C, Dennis M, Wardlaw J, Sandercock P. Stroke *The Lancet* Vol. 362, Issue 9391, 11 October 2003 P1211-1224.
10. The Global Burden of Disease – 2004 update - World Health Organization 2008.
11. The Global Burden of Disease – 2004 update - World Health Organization 2008.
12. Nichols M, Townsend N, Luengo-Fernandez R, Leal J, Gray A, Scarborough P, Rayner M (2012). European Cardiovascular Disease Statistics 2012. European Heart Network, Brussels, European Society of Cardiology, Sophia Antipolis P10.
13. WHO Deaths from stroke. Available from: <http://www.who.int/cardiovascular-diseases/en/cvdatlas16deathfromstroke>.
14. Leys D, Kwiecinsky H, Bogoslavsky J, Bath P, Brainin M, DeZ. iner HC. Prevention. *Cerebrovasc Dis* 2004; 17:15-29.
15. Leys D, Kwiecinsky H, Bogoslavsky J, Bath P, Brainin M, DeZ. iner HC. Prevention. *Cerebrovasc Dis* 2004; 17:15-29.
16. Feigin VL, Lawes CMM, Bennet DA, Anderson CS. 18. Stroke epidemiology a review of population-based studies of incidence, prevalence, and case-fatality in the late 20 th century. *Lancet Neurol* 2003; 2:43-53.
17. Jakovljević Đ, Mićović P. Zdravstveno stanje i zdravstvene potrebe stanovništva Srbije. Beograd: Palgo centar; 2004.

18. WHO. Global burden of stroke. Available from: <http://www.who.int/cardiovascular diseases/en/cvdat-las15burdenstroke>.
19. Gourie-Devi M, Gururaj G, Satishchandra P. Neuroepidemiology in developing countries. A manual for descriptive studies. 2nd edition. Prismic Books Pvt. Ltd. 1997.
20. Jain S, Maheshwari MC. Cerebrovascular disease: a review of the Indian experience in the last 35 years. *Neuroepidemiology* 1986; 5:1-16.
21. Rothwell PM, Coull AJ. Change in stroke incidence, mortality, case-fatality, severity, and risk factors in Oxfordshire, UK from 1981 to 2004. (Oxford Vascular Study). *Lancet* 2004; 363:1925-34.
22. Appelros P, Stegmayr B, Terént A. Sex Differences in Stroke Epidemiology: A Systematic Review. *Stroke*. 2009; 40:1082-1090; originally published online February 10, 2009; doi: 10.1161/STROKEAHA.108.540781.
23. Antic I, Petrovic B, Rancic N. Cerebrovascular disease morbidity on the territory of the municipality of Doljevac. *Med Pregl* 2011; LXIV (5-6): 267-273. Novi Sad: maj-juni.
24. Petrea RE, Beiser AS, Seshadri S, Kelly-Hayes M, Kase CS, Wolf A. Gender differences in stroke incidence and poststroke disability in the framingham heart study. *Stroke* 2009;40: 1032-7.
25. Buljan K, Hlavati M. Epidemiology of stroke hospitalized patients at Nasice general country hospital 1997 - 2001. *Acta clin Croat*, Vol. 41, Suppl. 3, 2002.
26. Smajlovic DZ, Ibrahimagic O, Dostovic Z, Tupkovic E, Sinanovic O. Main epidemiologic characteristics of cerebrovascular disease in patients hospitalized at Tuzla department of Neurology during a five-year post war period (1996-2000). *Acta clin Croat*, Vol.41, Suppl. 3, 2002.

SOME EPIDEMIOLOGIC FEATURES OF CEREBROVASCULAR DISEASE IN PATIENTS TREATED IN THE CLINIC OF NEUROLOGY AT THE UNIVERSITY CLINICAL CENTER OF KOSOVA IN PRISTINA

Shatri N.¹, Bara P.², Blyta A.¹, Dakaj N.¹, Vranica S.¹, Isaku E.¹, Zeqiraj K.¹, Jashari F.¹

¹ University Clinical Center – Clinic of Neurology

² University Hospital Center “Mother Teresa”, Tirana, Albania

ABSTRACT

Introduction: Cerebrovascular diseases (CVD) are the most common neurological disorder and the most common cause of disability.

The aims of this study are to compare the prevalence of CVD with other neurological diseases, CVD distribution by age and sex, the relationship between types of CVD, as well as to analyze the inpatient mortality in the Clinic of Neurology in the University Clinical Centre of Kosovo during the period January - December, 2010.

Methods: Retrospectively is analyzed medical documentation of 2384 patients hospitalized in the clinic of Neurology during the period January - December, 2010. The diagnosis of CVD is established on the basis of clinical examination of patients and neuroimaging examination of the brain (computed tomography or magnetic resonance imaging).

Results: During the period January - December 2010 at the clinic of Neurology have been hospitalized 2384 patients. Of these 1115 (47%) were the CVD and 1269 (53%) with other neurological diseases. Of 1115 patients with CVD, 534 (48%) were male and 581 (52%) female. With ischemic stroke were 872 (78%), 37 (3%) with transitory ischemic attack, 152 (14%) with intracerebral hemorrhage, 24 (2%) with subarachnoid hemorrhage. The overall hospital mortality was 11%, 89% of these due to CVD.

Conclusion: CVD are the first cause of morbidity and mortality in the clinic of Neurology.

Key words: cerebrovascular accidents, ischaemic stroke, intracerebral haemorrhage, computed tomography.

INCIDENCA E BARTËSVE TË STREPTOTKOKUT TË GRUPIT A TEK FËMIJËT E SHËNDOSHË TË MOSHAVE SHKOLLORE

THE INCIDENCE OF CARRIERS OF STREPTOCOCCUS GROUP A AMONG THE HEALTHY CHILDRENS OF SCHOOL AGE

Dika – Haxhirexha F.¹, Lito – Kuli Gj.², Todorovska M.³, Koxha S.²

¹ OPH “Alba-Med” – Dibër

² QSU “Nënë Tereza” – Tiranë

³ Laboratori biokimik-mikrobiologjik “Adrialab-Synlab” – Shkup

Autori për korespondencë: e-mail: ferizata@yahoo.com

Medicus 2014, Vol. 19 (3): 480 -478

ABSTRAKTI

Fëmijët e moshave shkollore të cilët janë bartës të SGA konsiderohen një faktor i rëndësishëm në përhapjen e këtyre patogjenëve mes fëmijëve. -

Qëllimi: të studiojmë prevalencën e bartësve të SGA mes fëmijëve të shëndoshë të moshave shkollore në qytetin e Dibrës dhe Shkupit.

Metodat: janë marë strishot faringeale nga 978 fëmijë shkollor të moshave nga gjashtë e deri në tetëmbëdhjetë vjeçare nga dy lokalitete të ndryshme (Shkupi dhe Dibra). Strishot u morën përmes një tamponi steril dhe u dërguan në laboratorin mikrobiologjik “Adria Lab” të Shkupit ku u kultivuan në terene ushqyese me agar gjaku.

Rezultatet: në këtë studim kemi egzaminuar 978 fëmijë në apartencë të shëndoshë nga shkollat fillore të Dibrës dhe të Shkupit përmes marrjes së strishove faringeale. Egzaminimet treguan strisho pozitive tek 109 prej tyre duke shënuar një prevalencë të bartësve të streptokokut të grupit A prej 11.1 % mes këtyre fëmijëve të shëndoshë.

Bazuar në studimin tonë rezultojnë se nuk janë vërejtë dallime të rëndësishme statistikore sa i takon distribuimit të bartësve lidhur me vendbanimin e këtyre fëmijëve. Dallime të rëndësishme statistikore rezultuan kur ne krahasuam fëmijët e përfshirë në studim sipas moshës së tyre (veçanërisht ky dallim ishte relevant gjatë krahasimit të grupmoshave 11 – 15 vjeçare me ato nga 6 deri në 10 dhe nga 15 deri në 18 vjeçare).

Përfundim: rezultatet e këtij studimi sugjerojnë se prevalenca e bartësve të SGA tek fëmijët e moshave shkollore është e ngjajshme me shumë studime të tjera të kësaj natyre. Të dhënat dhe dallime që rezultojnë nga ky studim duhet të miren në konsideratë nga mjekët pediatër gjatë përpilimit të algoritmeve të trajtimit të këtyre infeksioneve.

Fjalët kyç: SGA, bartësit, fëmijët e moshës shkollore.

HYRJE

Streptokoku pyogjen është bakterie patogjene shkaktare e morbiditetit dhe mortalitetit kudo në botë. Të shumta dhe të ndryshme janë sindromat klinike të cilat shkaktohen nga *Streptococcus pyogenes* (streptokoku betahemolitik i grupit A; BHS-A). Spektri i sëmundjeve të shkaktuara nga SGA ndahet në sipërfaqësore, invazive, ato të shkaktuara nga toksinet dhe çregullimet post infektive [1]. Megjithatë sëmundjet më të shpeshta

që mund ti shkaktojnë SGA janë faringitet dhe pyodermitë që hasen veçanërisht tek fëmijët [2,3,4].

Infeksionet me SGA janë dokumentuar tek të gjitha racat, moshat dhe gjinitë.

Llogaritet se SGA janë shkaktare të mbi 18 milionë infeksioneve të rënda nga të cilat rreth 517,000 prej tyre përfundojnë me vdekje të pacientëve [5]

Moshat më të atakuara nga SGA janë ato nga 5 deri 15 vjeçare me një pikë kulmore të incidencës në vitet e para të shkollës, ndërsa sa i takon gjinisë nuk ka ndonjë predominim të asnjërës prej tyre.

SGA kanë një aftësi dhe potencial shumë më të madh të invadojnë qelizat se sa ajo që kanë bakteret patogjene intraqelizore si *Listeria* dhe *Salmonela*. Kjo aftësi e tyre e internalizimit duket se është faktori më i rëndësishëm në perzistimin e baktereve dhe paraqitjen e bartësve [6].

Të dhënat epidemiologjike tregojnë për atë se fëmijët e moshës shkollore ose parashkollore kanë një prevalencë më të madhe të bartësve [7].

QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij punimi është krijimi i një pasqyre të përafërt të karakteristikave epidemiologjike të infeksioneve me SGA në popullatën e fëmijëve të shëndoshë të moshave shkollore në qytetet e Dibrës dhe Shkupit sa i takon incidencës së bartësve asimptomatik të këtyre infeksioneve.

Njëkohësisht përmes këtij studimi duam:

- Të tregojmë dallimet në incidencën e bartësve të SGA bazuar në moshën e fëmijëve të përfshirë në studim
- Të tregojmë dallimet e mundshme në incidencën e bartësve mes fëmijëve të këtyre dy qyteteve
- Të evidentojmë treguesit e ndryshëm epidemiologjik në kontigjentin e fëmijëve bartës për SGA.

MATERIALI DHE METODAT

Me qëllim të studimit të shkallës së bartësve të infeksioneve me SGA kemi testuar 978 fëmijë të moshave shkollore të qyteteve të Dibrës dhe Shkupit në periudhën kohore prej Gushtit të vitit 2010 e deri në Prill të vitit 2012.

Egzaminimet u realizuan gjatë kontrolleve rutinë që ju është bërë këtyre fëmijëve nga ana e mjekut pediatër, ndërsa gjatë marrjes së strishove jemi siguruar që fëmijët nuk kanë qenë të sëmurë dy javët e fundit dhe nuk kanë marrë asnjë preparat me antibiotikë. Të dhënat për gjëndjen shëndetësore të fëmijëve të përfshirë në studim u morën nga ana e prindërve.

Mosha e fëmijëve të përfshirë në studim shkon nga gjashtë vjeçare e deri në tetëmbëdhjetë vjeçe. Strishot u morën në dy periudha kohore edhe atë nga fundi i muajit gusht e deri në fund të muajit shtator si dhe përgjatë

muajve shkurt dhe mars muaj këto që përkojnë me stinën e verës dhe dimrit.

Për kultivimin dhe identifikimin e SGA strishot faringeale u dërguan në laboratorin mikrobiologjik “Adria-Lab” – “Synlab” të Shkupit. Atje strishot e maruna janë mbjellë në terene ushqyese speciale. Në këta terene është përdorur agari i gjakut me 5 % gjak delesh dhe pllaka selektive me 40 mg/l acid nalidiksik. Inkubimi zakonisht ka zgatur 24 orë në temperaturë prej 37°C ndërsa inkubimi i zgatur është përdorur për rastet e paqarta. Diagnoza përfundimtare është bërë përmes testit të bacitracinës.

REZULTATET

Të dhënat e fituara nga e egzaminimi i 978 fëmijëve të egzaminuar u klasifikuan bazuar në moshën si dhe vendbanimin e tyre.

Analizën e të dhënave të cilat rezultuan pas mbjelljes së strishove të marruna nga fëmijët e përfshirë në studim, e kemi paraqitur në mënyrë tabelare dhe përmes grafikoneve.

Prej 978 fëmijëve të përfshirë në këtë studim strishot pozitive për SGA rezultuan tek gjithsej 109 prej tyre ose 11.15 %.

Në tabelën 1 është paraqitur incidenca e SGA tek strishot faringeale në grupin e fëmijëve nga klasa e parë deri në të katërtën, nxënësve nga klasa e pestë deri në klasën e tetë si dhe nxënësve të shkollës së mesme.

Tab. 1 : distribuimi i fëmijëve sipas grupmoshave

Grupet	Mosha	Streptococcus pyogenes +	Streptococcus pyogenes -
1	6 deri ne 9 vj. (klasa e I-IV) n=684	86(12,57%)	598(87,43%)
2	11 deri ne14 vj. (klasa V-VIII) n=194	16(8,25%)	178(91,75%)
3	15 deri ne 18 vj. gjimnazi n=100	7(7%)	93(93%)

Pra nëse analizojmë ndaras sipas grup moshave nxënësit e përfshirë në studim shihet se incidenca më e lartë e bartësve është regjistruar në fëmijët e moshës nga 6 – 9 vjeçare respektivisht tek ata nga klasa e parë deri në atë të katërtën, ndërsa ajo më e ulët tek fëmijët e moshës nga 14 – 18 vjeçare ose gjimnazistët.

Në analizën e riskut sipas grupmoshave do të shqyrtohen

të dhënat për 978 personat e përfshirë në studim prej të cilëve 684 (69.94%) janë fëmijë nga klasa e parë deri në të katërtën (grupi 1), 194 (19.84%) nga klasa e pestë deri në të tetën (grupi 2), dhe 100 fëmijë (10.22 %) janë nga gjimnazi (grupi 3).

Në këtë grup prej 978 fëmijësh të moshave nga klasa e parë e shkollës fillore deri në vitin e katërt të shkollës së mesme respektivisht nga moshë 6 vjeçare deri në atë 18 vjeçe, SGA është izoluar në 109 strisho faringeale gjë që paraqet një shpeshësi prej 11.1 %. Tabela 2.

Tabela 2. Distribrimi i fëmijëve sipas pranisë së SGA

Streptococcus pyogenes	N	%
Negativ	869	88,85
Pozitiv	109	11,15
Gjithsej	978	100

Në tabelën 3 është paraqitur distribuimi i fëmijëve të moshave 6, 7, 8 dhe 9 vjeçare sa i takon shpeshësisë së bartësve të streptokokut të grupit A. Bakteria shënon një incidencë të përfaqësimit të saj prej 12.8 % tek fëmijët e moshës gjashtë vjeçare, 14 % tek ata shtatë vjeçar, 12 % tek fëmijët tetë vjeçar dhe 10.1 % tek ata nëntë vjeçar.

Tabela 3. Shpeshësia e Streptococcus pyogenes - moshë nga 6 deri në 9 vjeçare

	Moshë	Streptococcus pyogenes -	Streptococcus pyogenes +	Row
Count	6	191	28	219
Row Percent		87,21%	12,79%	100%
Count	7	197	32	229
Row Percent		86,03%	13,97%	100%
Count	8	103	14	117
Row Percent		88,03%	11,97%	100%
Count	9	107	12	119
Row Percent		89,92%	10,08%	100%
Count	All Grps	598	86	684

Pearson Chi-square=1,13 df=3 p=0,77

Në tabelën 4 paraqitet distribuimi i fëmijëve të moshave 11, 12, 13 dhe 14 vjeçare në varshmëri nga incidenca e gjetjes së streptokokut pyogjen në strishot faringeale të tyre. Bakteria shënon një incidencë të përfaqësimit të saj prej 6.45% tek fëmijët e moshës 11 vjeçare, 8.7% tek ata 12 vjeçare, 9.47% tek fëmijët e moshës 13 vjeçare dhe 4.55 % tek ata 14 vjeçar. Përlllogaritja e dallimeve në incidencën e bartësve të streptokokut pyogjen të grupit A bazuar në moshën e fëmijëve 11, 12, 13 dhe 14 vjeçare

në aspektin statistikor është jo sinjifikativ respektivisht i parëndësishëm ($p=0.9$).

Tabela 4. Incidenca e Streptococcus pyogenes - në moshat nga 11 deri në 14 vjeçare

	Moshë	Streptococcus pyogenes -	Streptococcus pyogenes +	Row
Count	11	29	2	31
Row Percent		93,55%	6,45%	100%
Count	12	42	4	46
Row Percent		91,30%	8,70%	100%
Count	13	86	9	95
Row Percent		90,53%	9,47%	100%
Count	14	21	1	22
Row Percent		95,45%	4,55%	100%
Count	All Grps	178	16	194

Pearson Chi-square=0,73 df=3 p=0,87

Në tabelën 5 është pasqyruar distribuimi i fëmijëve të moshës 15, 16, 17 dhe 18 vjeçare bazuar në incidencën e gjetjes të streptokokut pyogjen në strishot faringeale të tyre. Nga të dhënat shihet se tek personat e moshës 17 vjeçare nuk është regjistruar asnjë strisho pozitive, ndërsa tek personat e moshës 15 vjeçare strishot pozitive kanë rezultuar tek 15.4 % e tyre, tek ata 16 vjeçar 8.2 % ndërsa tek 18 vjeçarët 8.33 % e strishove kanë qenë pozitive në streptokokun e grupit A. Testimi i këtyre dallimeve në incidencën e bartësve të SGA në varshmëri nga moshë e personave të përfshirë në studim 15, 16, 17 ose 18 vjeçare në aspektin statistik është josinjifikativ respektivisht i parëndësishëm ($p=0.3$).

Tabela 5. Incidenca e Streptococcus pyogenes - moshë nga 15 deri në 18 vjeçare

	Moshë	Streptococcus pyogenes -	Streptococcus pyogenes +	Row
Count	15	11	2	13
Row Percent		84,62%	15,38%	100%
Count	16	45	4	49
Row Percent		91,84%	8,16%	100%
Count	17	26	0	26
Row Percent		100,00%	0,00%	100%
Count	18	11	1	12
Row Percent		91,67%	8,33%	100%
Count	All Grps	93	7	100

Pearson Chi-square= 3,49 df=3 p=0,32

Nëse analizojmë incidencën e bartësve të SGA në grupin e fëmijëve nga klasa e parë deri në atë të katërt, në këtë studim ai rezulton të jetë 12.6 %. Në grupin e fëmijëve nga klasa e pestë deri në atë të tetë kjo incidencë shkon në 8.25 %, ndërsa në grupin e nxënësve të shkollës së mesme vetëm 7 % e strishove faringeale kanë rezultuar pozitive në *Streptococcus pyogenes*. Megjithatë ky dallim i regjistruar sa i takon nivelit shkollor të fëmijëve duket i pamjaftueshëm që të mund të llogaritet si sinjifikativ në aspektin statistikor, respektivisht i rëndësishëm ($p = 0,09$). Tabela 9.

Tabela 9. Incidenca e *Streptococcus pyogenes* – grupet sipas nivelit shkollor.

	Grupi	<i>Streptococcus pyogenes</i> -	<i>Streptococcus pyogenes</i> +	Row
Count	Klasa. 1-4	598	86	684
Row Percent		87,43%	12,57%	100%
Count	Klasa 5 8.	178	16	194
Row Percent		91,75%	8,25%	100%
Count	Gjimnazi	93	7	100
Row Percent		93,00%	7,00%	100%
Count	All Grps	869	109	978

Pearson Chi-square=4,78 df=2 p=0,

DISKUTIM

Streptokokët e grupit A (SGA) mbeten akoma një patogjen mjaft i rëndësishëm për shkak të aftësive të tyre që të provokojnë një shumëllojshmëri të madhe të infeksioneve nga të cilat bakteremia mbetet më e rënda. Kalimi i një periudhe ditore në kushte të kolektivitetit si shkolla apo çerdhe, kontaktet intensive me persona tjerë të infektuar janë faktorë të cilët llogariten si shkaktarë të këtyre infeksioneve tek fëmijët, ndërsa tek të rriturit ka disa faktorë si moshë e shtyrë, sëmundjet kardiovaskulare, diabeti, sëmundjet malinje të cilat risin shkallën e rrezikshmërisë nga këto infeksione[8,9,10].

Sot infeksionet me streptokokun pyogjen mbeten akoma një problem i madh shëndetësor jo vetëm në vendet në zhvillim por edhe në ato të zhvilluara.

Në këtë studim jepet një pasqyrë e incidencës të bartësve të streptokokut të grupit A mes fëmijëve të moshave shkollore në një periudhë kohore dyvjeçare. Gjykojmë se një numër prej 978 fëmijësh të moshave shkollore të përfshirë në këtë studim paraqesin një kuantum të

mjaftueshëm për një analizë të mirëfilltë shkencore sa i takon incidencës së bartësve të infeksioneve me SGA mes fëmijëve të moshës shkollore në popullatën tonë.

Të dhënat për incidencën e bartësve mes fëmijëve të moshës shkollore në literaturë janë të shumta. Në studimin tonë ne kemi marrë strishot faringeale nga fëmijët e cikleve të ulëta (klasa e parë deri në të katërt), ata të cikleve të larta (nga klasa e pestë e deri në të tetën) dhe një grup fëmijësh janë ata të shkollës së mesme. Të gjithë këta fëmijë në çastin e marrjes së strishove faringeale kanë qenë plotësisht të shëndoshë pa kurrfarë shqetësimesh ose shenjash të infeksioneve të traktit të sipërm respirator.

Këto strisho faringeale të marruna vetëm njëherë nga fëmijët e shëndoshë mund të japin të dhëna të cilat në fakt pasqyrojnë gjendjen e cila haset në një moment të caktuar tek popullata e cila studiohet. Rezultatet të cilat dalin nga studimet e këtilla mund të definohen qoftë si incidencë, bartës asimptomatik të SGA ose kolonizim.

Sot ajo që tërheq më së shumti vëmendjen e studiuesve të ndryshëm sa i takon infeksioneve me SGA është fenomeni i bartësve e që zakonisht njihet si perzistencë e patogjenit në organizmin e amvisit. Në praktikën pediatrike bartësi dhe kolonizimi vështirë dallohen mes veti. Shpesh kolonizimi lidhet me praninë e bakterieve jo patogjene qëllimi i të cilave është që të vendosen në inde por të mos e dëmtojnë amvisin. E këtillë është flora normale oro-faringeale e cila ndonjëherë mund të përmbajë edhe bakterie patogjene por përderisa këto bakterie janë në baraspeshë me florën normale nuk paraqesin rrezik potencial për paraqitjen e ndonjë sëmundje dhe personat e tillë llogariten si bartës [10, 3].

Në këtë studim janë përfshirë 978 fëmijë të moshave të ndryshme, ndërsa strishot faringeale i kemi marrë në dy periudha kohore edhe atë në muajt shtator (verë) që përkon me fillimin e vitit shkollor dhe në muajin mars (dimër).

Me qëllim të pasjes së një pasqyre sa më objektive të rezultateve tona ato i kemi krahasuar me rezultatet e publikuara nga shumë autorë të ndryshëm.

Sa i takon incidencës së bartësve të streptokokut pyogjen mes fëmijëve të shëndoshë të moshave shkollore në literaturë hasen të dhëna të cilat mes veti dallojnë shumë. Kështu disa studime dhe autorë si Pichichero, Breese dhe Hofkosh referojnë për një incidencë më të ulët të bartësve tek fëmijët e moshave shkollore krahasuar me atë që

rezulton nga studimi ynë - respektivisht incidenca në studimet e tyre shkon nga 2.5 e deri më 11% [11,12,13,14].

Një studim i ndërmarrë nga Hoffman në Danimarkë i cili ngjashëm si studimi ynë nuk është longitudinal tregon për një incidencë të bartësve prej 2.2 %, por këto vlera kaq të ulëta në incidencën e bartësve janë si rezultat i përfshirjes së një popullate më të vjetër në studim krahas asaj të fëmijëve shkollor[15]. Koshi[16] në studimin e tij të realizuar në distriktin e Vellore në Indi referon për një incidencë edhe më të ulët të bartësve të SGA respektivisht prej 2.3 %, ndërsa në një studim tjetër të ndërmarrë po në Indi nga Kumar[17] tek fëmijët e moshës mes 5-15 vjeçare incidenca e bartësve rezulton të jetë rreth 1.3 %. Kjo incidencë është dukshëm më e vogël se ajo e shumë studimeve të tjera të ndërmarrë nga studiues nga India dhe vende tjera [18,19].

Incidencë të ulët të bartësve të SGA referon edhe Pichichero[11] i cili në studimin e tij ku janë përfshi 125 fëmijë të shëndoshë të moshave shkollare gjithashtu tregon për një incidencë të ulët të bartësve prej 2.5 %, ndërsa Menon[20] dhe Dhakal[21] në studimin e tyre referojnë për një incidencë të bartësve të SGA prej 4.5 %.

abdominal pain irradiated to the back, jaundice, malaise and weight loose. The CT examination and ECHO tomography demonstrated dilated common bile duct but did not reveal the presence of the stone at the common bile duct. The biochemistry data showed the high level of serum carbohydrate antigen 19-9 and total bilirubin. Intraoperatively a impacted stone was found in the distal part of the common bile duct below the pancreas head. Nine weeks after surgical removal of the stone the level of the of serum carbohydrate antigen 19-9 was returned at the normal value.

Key words: choledocholithiasis, obstructive jaundice, CA 19-9

Të nderuar lexues të revistës IMJ Medicus, në shenjë respekti për mjekët dhe shkencëtarët tjerë të fushës biomjeksore, si dhe duke marrë parasysh nevojën për kultivimin e vlerave tona tradicionale si bazament i të arriturave të pastajme, Redaksia ka vendosuar që për çdo numër të Medicusit të publikojë nga një portret të shkurtër për mjekët e traditës sonë, të bindur se edhe kjo mënyrë do ti shërbejë motivimit dhe angazhimit më këmbëngulës së gjeneratave të rëja për arritje më të mëdha.

Prof. dr. Jusuf Rexhepi (1922-2004)



Personalitet i spikatur i mendimit shkencor, kulturor e politik, frymëzues i progresit me vision të qartë

Në vazhden e shpalosjes së kujtimit për personalitete të ndryshme që kanë lënë gjurmë në trashëgiminë tonë në fushën e mjeksisë dhe jo vetëm, në këtë numër jubilar, në Dhjetëvjetorin e botimit të parë të Revistës “Medicus” menduam që emri i Profesorit tonë të nderuar Jusuf Rexhepi, do ta nderonte dhe do t’ia shtonte vlerën këtij përvjetori. Kjo si për faktin që ai ishte ndër frymëzuesit dhe mbështetësit kryesor në themelimin e Shoqatës të mjekëve, stomatologëve dhe farmacistëve shqiptarë të Republikës së Maqedonisë që në fillimet e viteve të nëntëdhjeta, po ashtu edhe për kontributin e drejtëpërdjejtë që dha në konsolidimin dhe afrimin e aktivitetit të kësaj shoqate duke përfshirë këtu edhe vizionin për aktivitetin botues të revistës Medicus.

Jeta e tij profesionale dhe sociale është në kujtimin e shumë brezave dhe sidomos të mjekëve të shumtë, studentëve të tij si dhe të shumë pacintëve që ai me aq kujdes iu përkushtua. Por dimensionin e aktivitetit të tij nuk është lehtë të përfshihet në një shkrim të shkurtër si ky. Ata që kanë pasur fatin ta njohin nga afër profesorin, e kanë vështirë t’i shprehin me pak fjalë kujtimet e mbetura nga takimet me këtë njeri të veçantë për shumëçka.

Në një Monografi të botuar pas ndarjes nga jeta të Dr. Jusufit, sikurse shumica e kanë quajtur, Prof. dr. i nderuar Remzi Nesimi me shumë kujdes dhe realizem

do të shkruante: “Ndër shqiptarët e Maqedonisë e më gjerë, padyshim, nga figurat më të spikatura të mendimit shkencor, kulturor e politik është edhe ajo e Prof. dr. Jusuf Rexhepit, të cilin e njohim, jo vetëm si pedagog të arsimit të lartë, por edhe si studiues të zellshëm, si intelektual me formim të gjithanshëm e kulturë të gjerë, e mbi të gjitha, si atdhetar të devotshëm dhe të papërkulshëm.”

Prof. dr. Jusuf Rexhepi ka një biografi tejet interesante dhe mbase edhe karakteristike për njerëz që janë pjesë dhe kalojnë epokat. Ai u lind në Tetovë, më 15 qershor të vitit 1922. Në vendlindje ka vijuar mësimet në shkollën fillore dhe gjimnazin në gjuhën serbokroate në Jugosllavinë e atëherëshme monarkiste. Ka mbaruar maturën më 1942 në gjimnazin Sami Frashëri në Prishtinë. Këtu ai, duke u ndodhur në duart e edukatorëve më të njohur të kohës, përveç që pajiset me njohuri dhe kompetenca solide, ngjesh në vehte edhe brumin atdhetar dhe para tij hapet një botë tjetër, një vision shumë më ambicioz dhe pretendues që më vonë do ta realizojë si në aspektin profesional si mjek, po ashtu edhe në aspektin e pikpamjeve të tija për kahjet e zhvillimit dhe dretimit të çështjes kombëtare.

Studimet e mjekësisë i filloi gjatë luftës së dytë botërore në Itali (Bari), i vazhdoi në Vjenë dhe diplomoi, pas lufte, në Beograd. Pasi punoi një kohë si mjek i praktikës së përgjithshme në vendlindje, në Tetovë, shkoi në Shkup për

të specializuar mjekësinë interne dhe si mjek specialist vazhdoi të shërbejë në Tetovë. Në ndërkohë në Beograd i kreu studimet postdiplomike në lëmin e kardiologjisë.

I përgatitur në këtë fushë ai u bë internist i parë në Tetovë dhe themelues i Repartit Internistik në Tetovë ku për herë të parë filloi të profilizohet edhe shërbimi kardiologjik.

Në vitin 1973 ftohet në fakultetin e posahapur të mjekësisë në Prishtinë ku emërohet ligjërues për lëndën e mjekësinë interne. Atje përgatiti dhe mbrojti tezën e doktoraturës me titull “Studimet epidemiologjike mbi faktorët e rrezikut të sëmundjeve koronare te punëtorët industrial të Kosovës.”

Profesor ordinar për lëndën Mjekësia Interne është emëruar në vitin 1985 dhe përveç punimeve shkencore përpiloi dhe botoi tekstin universitar: “Ekzaminimi klinik i sëmundjeve të brendshme”. Teksti në fjalë doli nga shtypi në vitin 1984.

Përveç detyrës si ligjërues, gjer në pensionim ka kryer detyrën e Kryeshefit të Kardiologjisë në Klinikën Interne dhe Shefit të katedrës për Mjekësi Interne.

Doktori kudo që shkonte e punonte gjente miq, krijonte të tjerë dhe linte miq të shumtë kur detyrohej të largohej. Ata që kanë pasur fatin ta njohin nga afër e kanë vështirë t'i shprehin me fjalë kujtimet e mbetura nga takimet me këtë njeri të veçantë për shumëçka. Them kështu, sepse jeta dhe veprat e kësaj figure të nderuar ka qenë një gërshetim bëmash, ndodhishë dhe situatash tepër sfiduse dhe me peshë në historinë e afërt të shqiptarëve.

Duke qenë ndër mjekët dhe intelektualët e parë, atij i takoi barra që ai me kënaqësi e pranoi për të qenë gjithmonë në ballë të iniciativave afirmative të shqiptarëve, qofshin ato të karakterit politik, arsimor, kulturor, mjekësor etj. Të jesh i tillë në rrethanat e njohura që u krijuan për



shqiptarët që pas luftës së Dytë Botërore deri në shembjen e monizmit, por edhe më pas, nëkupton angazhim tej mase, suksese dhe dëshpërime, dhimbje dhe krenari dhe shumë përjetime tjera të ndryshme që nuk ishin vetëm pjesë e fatit të tij personal, por para së gjithash ishin njehsim me fatin e përgjithshëm të kombit shqiptar.

Profesor Jusuf Rexhepi, në të gjitha këto faza që kaluan shqiptarët dhe ai vetë në 60 vitet e fundit të shekullit që kaloi dhe në këtë që po e jetojmë, qëndroi dinjitoz dhe i papërkulur, duke rrezatuar gjithmonë optimizëm, guxim qytetar dhe fisnikëri të pashoq, virtyte këto të nevojshme për kohën dhe hapësirën ku ai vepronte, të nevojshme për gjeneratat e reja intelektuale që sapo kishin nisur të lëshonin shtat.

Ai nuk e kurseu veten dhe ishte përkrah të gjitha iniciativave dhe organizimeve shpresëdhënëse për shqiptarët e Maqedonisë në veçanti. Përkundër angazhimit konstant dhe të përditshëm si mjek, ai gjeti kohë dhe energji për të mbështet që në fillet e saj themelimin e Shoqatës së mjekëve, stomatologëve dhe farmacistëve shqiptarë, ku me prezencën dhe sugjerimet e veta u bë gurthemeli më i çmuar i kësaj strukture.

Ai ka qenë dhe do të mbetet njëri ndër figurat më frymëzuese të kombit shqiptar, për idealet e të cilit do të kenë se çka të thonë edhe gjeneratat që vijnë.

Krenar që një kohë të gjatë edhe ne e patëm pranë, Bordi Editorial i Revistes Medicus, ka nderin që ta kujtojë në mënyrë simbolike m'u në Dhjetëvjetorin e botimit të numrit të parë të Revistes Medicus, në shenjë respekti dhe falënderimi për kontributin e Profesor Jusufit për themelimin dhe konsolidimin e Shoqatës, themeluese e Revistës “Medicus”.

Prof. dr. A. Pollozhani

Konferenca e 12-të e Asamblesë së Përgjithshme të AERSH (Asociacioni Evropian për Redaktim Shkencor) - EASE, Split 2014

Bota komplekse e redaktimit shkencor

Nga 13 deri në 15 qershor të këtij viti në Split, Kroaci, Asociacioni Evropian për Redaktim Shkencor (EASE) mbajti Konferencën e 12-të. Ky asociacion përbëhet nga redaktorët e revistave biomjekësore të Evropës dhe më gjërë dhe ka për qëllim që të harmonizojë dhe përparojë cilësinë e botimeve shkencore duke ndërruar përvojë dhe njohuri nga anëtarët e vet dhe bashkëpunëtorë tjerë kompetent jashtë saj. Me këtë rast, në cilësinë e Kryeredaktorit të Revistës *IMJMedicus*, prezentova përvojën tonë modeste, por tepër interesante të aktivitetit të redaktorëve të Revistës tonë dhe shpreha gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm në interes të avansimit të botimeve biomjekësore në përgjithësi dhe të punës redaksionale në veçanti.

Pas hapjes formale që u bë nga ana e kryetares së AESE, zonja Walsh dhe Kryetares të Këshillit organizativ Prof. Ana Marushiq, ligjëratën bosht të Konferencës e mbajti Prof. Tim Hant (Professor Sir Tim Hunt) laureat i çmimit Nobël për fiziologji dhe mjekësi në vitin 2001, për zbulimet e molekulave proteinike që kontrollojnë ndarjen (dyfishimin) e qelizave.

Sir. Tim Hunt, në ligjëratën e mbajtur zgjoi shumë interesin dhe kërshërinë e të gjithë pjesëmarrësve. Ai përveç që shkurtimisht prezantoi aspektet bazike, parimore të hulumtimit të tij që qe vlerësuar nga ana e Komitetit të Çmimit Nobël, prezantoi edhe disa këndvështrime



filozofike mbi shkencën dhe hulumtimin shkencor që po ashtu do të mbeten në kujtimin e këndshëm të çdo pjesëmarrësi. Më posht do të prezantoj disa sekuanca të shkurtëra nga ajo që mbet në kujtesën time dhe që mendoj se do t'ia vlente që të meret parasysh. Ndërmjet tjerash u theksua se: "...ndonëse hapi më i rëndësishëm në procesin kërkimor është zgjedhja e çështjes për të hetuar (parashtrimi i pyetjes kërkimore)..." ose: "...Ajo çfarë i dallon shumicën e shkencëtarëve nuk është aftësia e tyre teknike, por ajo se çka ata zgjedhën për të zgjidh, a është problemi interesant...". Me sa duket "...të qenit interesant është më e rëndësishme se sa të qenit i drejtë!", sepse "...duke qenë më e rëndësishme, njerëzit që vijnë më pas



Professor Sir Tim Hunt

do ta korrigjojnë...”(edhe pse nuk ka qenë krejtësisht e drejtë).

Nga kjo del se “...Në qoftë se politika është arti i të mundshmes, hulumtimi është me siguri arti i të shpjegueshmes...”, etj. Etj.

Në konferencë, gjithashtu me shumë kompetencë, nga përfaqësues të revistave të ndryshme nga Evropa dhe Bota, u prezentua përvoja, sfidat, dilemat që një redaktori i parqiten në punën e tij tejet komplekse e cila fjalë edhe u zgjodh si kornizë pune e vetë konferencës: **“Bota komplekse e redaktimi shkencor”** që në fakt reflekton edhe dimensionin real të rrjedhave në sferën e botimit dhe redaktimit shkencor sot.

Një këndvështrim i veçantë iu dedikua edhe mënyrës së komunikimit sa më të përshtatshëm edhe në këtë rrafsh (redaktim dhe hulumtim shkencor) në një botë me shumë ngjyra në ambientin globalizues. Për këtë qëllim, u tha,



Me Z-njën Wlash

është shumë e rëndësishme që njohuritë empirike të shndërrohen në njohuri operacionale, me qëllim që ato të jenë të pranueshme dhe të kenë të njëjten vlerë dhe kupim për të gjithë kulturat. Kështu shkenca dhe botimet shkencore do të ruajnë karakterin e tyre universal dhe do t'u mundësohet që të gjithë njerëzit, pa dallim gjuhe, kulture apo race, ta kenë pranë vetes si e drejtë bazike të njeriut.



Prof Ana Marushiq, hap konferencen

UDHËZIME PËR AUTORET

*Këto të dhëna janë në pajtim me
“Kërkesat uniforme për Dorëshkrimet e Pranuara në
Revistat Biomjekësore”*

Dokumentin komplet mund ta gjeni në www.icmje.org

Medicus është revistë ndërkombëtare që boton punime origjinale shkencore, vështrime revyale, punime profesionale, prezente rasti, kumtesa të shkurtra, recensione librash, raporte nga tubime shkencore, letra dhe editoriale nga fusha e mjekësisë, stomatologjisë, farmakologjisë si dhe nga fusha tjera të përaferta biomjekësore.

Revista është organ i “Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë në Maqedoni.”

Gjuha e botimeve është në Gjuhë Shqipe dhe Angleze (këshilli redaktues mund të vendosë nëse botimet do të jenë edhe në gjuhë tjera). Autorëve u kërkohet të lektorojnë dhe të redaktojnë unimin e tyre vetë, në gjuhën përkatëse.

Ju lutemi përdoreni madhësinë standarde të punimit në format: *Word për Windows*, Times New Roman 12.

Dorëshkrimet dërgohen në format elektronik, qoftë me

CD ose përmes e-mailit tek Kryeredaktori,
Prof. Dr. Azis K. Pollozhani,
Zyra e Redaksisë, rr. 50 Divizija, No 6, 1000
Shkup, apo në
e-mail: medicus.shmshm@gmail.com

Revista për një numër pranon jo më shumë se një artikull nga një autor, dhe jo më shumë se dy si ko-autor.

Autorët duhet të deklarojnë se kontributi i tyre nuk është publikuar apo pranuar për publikim diku tjetër, përderisa nuk përfundon procedura vlerësuese në Revistën tonë.

Autorët gjatë aplikimit duhet të përmbushin formën e kërkuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Redaktorëve të Revistave Mjekësore (ICMJE) për **kriteret e autorësisë**, respektivisht “*Kërkesave uniforme për Dorëshkrimet e Pranuara në Revistat Biomjekësore*”, cilën mund ta gjeni në www.icmje.org.

Revista do të **njoftojë pranimin** e artikullit tuaj brenda shtatë ditësh dhe do t’ju bëjë me dije se kur do të informoheni për vendimin e këshillit redaktues.

Artikujt për t’u botuar në **Medicus** do të **recensohen**. Këshilli redaktues do të marrë parasysh komentet e recensuesit dhe pastaj mund të kërkojë nga autori ndryshime apo plotësim të punimit.

INFORMATION FOR AUTHORS

*These guidelines are in accordance with the
“Uniform Requirements for Manuscripts Submitted
to Biomedical Journals”*

(The complete document appears at www.icmje.org)

Medicus is an international journal of that publishes papers from all areas of medical research. Furthermore, the journal intends to bring educational material of high quality to its members for continuous medical education (CME), by publishing original research, professional and review papers, case reports, brief communications, literature summary articles and editorials.

The *Journal* is official organ of the »Association of Albanian Medical Doctors from Macedonia«.

The language of publication is Albanian and English (the editorial board may decide whether other language will be used for publications). Authors are requested to have their paper proof-read and edited for the respective language.

Please use standard-sized paper and submit your article in the following format: Word for Windows, Times New Roman 12.

Manuscripts should be submitted in electronic format, either on disc or by e-mail to the Editor-in-Chief,

Azis K. Pollozhani, MD. PhD
Editorial Office, Str. 50-ta Divizija, No 6, 1000
Skopje,
Email: medicus.shmshm@gmail.com

The *Journal* allows submission of no more than one article as an author, and at most two, being a co-author per issuance.

The authors attest that their contribution has neither been published nor submitted for publication elsewhere, until the editorial procedure is over.

Authors should adhere to the International Committee of Medical Journal Editors (ICMJE) **authorship criteria** in so far as they apply. These can be found at www.icmje.org.

The *Journal* will **acknowledge receipt** of your article within seven days and let you know when you will be informed of the editorial board’s decision.

Articles to be published in **Medicus** will be **peer-reviewed**. The editorial board will take into account the reviewer’s comments and may then prompt the author for changes or further work.

Numri i faqeve (përfshirë tabelat dhe/ose figurat/ ilustrimet) varet nga lloji i artikullit:

punim origjinal hulumtues –deri ne12 faqe dhe jo më shumë se 6 tabela dhe/ose grafikone/fotografi;

punim profesional ose punim revyjal – deri ne 8 faqe dhe jo më shumë se 4 tabela dhe/ose figura/imazhe;

prezantim rasti apo kumtesë e shkurtër – deri 6 faqe dhe maksimum 3 tabela dhe/ose figura/imazhe.

Letër redaksisë - deri 2 faqe

Së bashku me dorëshkrimin, dorëzoni një faqe me **titullin** e artikullit; **emrin/at e autorit/ve**, duke përfshirë emrin me jo më shumë se dy tituj shkencor; emrin e departamentit dhe institucionit në të cilin është bërë punimi; institucioni ku punon (për secilin autor); si dhe emri dhe adresa e autorit të cilit do ti adresohen kërkesat nga ana e Redaksisë (shihni Informacionet plotësuese për autorët)

Abstrakti duhet te jete me jo më shumë se 250 fjalë. Duhet të konsistojë në katër paragrafë, i klasifikuar në Hyrje, Metodot, Rezultatet dhe Diskutimi (Përfundimet). Ato duhet të përshkruhen shkurt, respektivisht, problem qenësor i studimit, se si është kryer studimi, rezultatet e fituara, dhe përfundimi.

Tabelat, figurat dhe legjendat (shihni Informacionet plotësuese për autorët)

Fjalët kyqe -Tri deri pesë flaje apo fraza te shkurtëra duhet t'i shtohen pjesës së fundme të faqes së abstraktit.

Citatet e referencave në tekst duhet fillimisht të jenë nga revistat e indeksuara në **PubMed**. Stili i referencave që kërkohej nga Medicus është i formatit Vancouver (shihni Informacionet plotësuese për autorët).

Shkurtime (akronimet) përdoren për njësitë matëse, kurse në raste tjera kur përmendet për herë të parë, ai duhet të jetë i sqaruar me fjalën bazë bashkangjitur.

Për të gjitha barnat duhet të përdoren **emrat gjenerik** ndërkombëtar. Nëse në hulumtim janë të përdorura brendet e patentuara, përfshini emrin e brendit në kllapa në paragrafin e Metodave.

Dorëshkrimi i dërguar tek botuesi duhet të shënohet nga autorët , nëse janë në seksionin e “punimeve origjinale shkencore” apo në pjeset tjera përmbajtësore të revistës.

Autorët marrin dy kopje të botimit përkatës.

The number of pages (including tables and/or figures/ illustrations) is dependent upon the type of the article:

original research paper - up to 12 pages and no more than 6 tables and / or graphs / pictures;

professional or review paper - up to 8 pages and no more than 4 tables and / or figures / images;

case report or brief communication - up to 6 pages and a maximum of 3 tables and / or figures/images.

Letter up to 2 pages

With the manuscript, provide a page giving the title of the paper; the name(s) of the author(s), including the first name(s) and no more than two graduate degrees; the name of the department and institution in which the work was done; the institutional affiliation of each author; and the name and address of the author to whom reprint requests should be addressed. (see Additional Information for Authors)

Provide an **abstract** of not more than 250 words. It should consist of four paragraphs, labeled Background, Methods, Results and Conclusions. They should briefly describe, respectively, the problem being in the study, how the study was performed, the salient results, and what the authors conclude from the results.

Tables, figures and legends (see Additional Information for Authors)

Three to five **key words** or short phrases should be added to the bottom of the abstract page.

Quotations of references in the text should primarily be from journals indexed in **PubMed** which have proven their significance. The style of references required by **Medicus** is the Vancouver format (see Additional Information for Authors).

Except for units of measurement, abbreviations are discouraged. The first time an abbreviation appears it should be preceded by the words for which it stands.

The international **generic names** should be used for all drugs. When proprietary brands are used in research, include the brand name in parentheses in the Methods section.

All manuscript sent to the editor should be noted by the authors whether they are meant for the “original research papers” section or the rest of the journal’s content.

The authors receive two copies of the relevant issue.

Informacione plotësuese për autorët

I. Faqja e parë – ballina: Duhet të përmbajë: (a) titullin e punimit, të shkurtër, por informativ; (b) emri, inicialet e emrit të mesëm dhe mbiemrit të secilit autor; (c) institucioni; (d) emri i departamentit që i atribuohet punës shkencore; (e) emri dhe adresa e autorit për t'iu përgjigjur në lidhje me dorëshkrimin; (f) burimi/përkrhja në formë të granteve, paisjeve, barnave dhe në përgjithësi.

II. Faqja e dytë – abstrakti dhe fjalët kyqe: Abstrakti duhet të shkruhet me maksimum prej 150 fjalësh për abstraktet e pastrukturuara, dhe me 250 fjalë për abstraktet e strukturuara (pjesët përmbajtësore: objekti/ete studimit ose hulumtimit, procedurat bazë, siç është përzgjedhja e subjekteve apo kafshët laboratorike, metodat vërtetuese dhe analitike, pastaj, rezultatet/gjetjet përfundimtare (të dhënat dhe rëndësia e tyre statistikore, nëse është e mundur), dhe konkluzionet kryesore. Vini theksin mbi aspektet e reja dhe të rëndësishme të studimit apo vërtimit. Nën abstraktin identifikoni dhe shkruani fjalët kyqe: 3-5 fjalë apo fraza të shkurtëra që do të ndihmojnë në paisjen me tregues të punimit dhe publikimit të abstraktit. Përdorni terme nga lista e Index Medicus për Nëntituj Mjekësor (Medical Sub-Headings [MeSH]); nëse nuk ka term të përshtatshëm në MeSH për disa terme të reja, mund të përdorni termet e dhëna.

III. Faqja e tretë dhe të tjerat – teksti i plotë i artikullit: Teksti i plotë I artikujve hulumtues ose vërtues normalisht, por jo domosdoshmërisht, duhet të jetë i ndarë në paragraf me këta nëntituj: hyrja, metodat dhe materialet, rezultatet dhe diskutimi.

1. Hyrja: Krijoni një kontekst apo prapavijë(truall) të studimit (që në fakt është natyra e problemit dhe rëndësia e tij). Për të bërë këtë duhet të bëni një hulumtim të literaturës – duke kërkuar, gjetur dhe lexuar punimet përkatëse, që duhet të jenë si referencë në dorëshkrimin tuaj. Sqaroni hipotezat tuaja dhe planifikoni t'i testoni ato, si dhe përshkruani qëllimet tuaja. Kini qëndrim të qartë se çka prisni të gjeni dhe arsyet që ju udhëhoqën tek hipotezat që keni krijuar. Objekti i hulumtimit më së shpeshti fokusohet kur parashtrohet si pyetje. Mos përfshini të dhëna apo rezultate nga puna që do të raportohet.

2. Metodatat & Materialet: Ky paragraf duhet të përfshijë atë informacion që ishte në dispozicion në kohën që plani apo protokoli i studimit po shkruhej. Të gjitha informacionet e marra gjatë studimit i takojnë paragrafit të Rezultateve.

Përshkruani përzgjedhjen tuaj të pjesëmarrësve së vërtimit ose eksperimentit (pacientët ose kafshët laboratorike, përfshirë kontrollat) qartë, duke përfshirë kriteret e përshtatshme (inkluzive) dhe përjashtuese (ekskluzive).

Parimi udhëheqës duhet të jetë i qartë se si dhe pse studimi është bërë në një mënyrë të caktuar. Jepni detaje të mjaftueshme për metodat, mjetet dhe materialet (jepni emrin dhe adresën e prodhuesit në kllapa), dhe procedurat për të lejuar të tjerët të kuptojnë dhe riprodhojnë rezultatet tuaja.

Nëse një metodë e caktuar që është përdorur është e njohur, atëherë nuk është e nevojshme të jepet përshkrim komplet i saj. Mund t'i referoheni punimit në të cilin së pari herë është përshkruar dhe të

Additional Information for Authors

I. First page - front page: It should contain: (a) title of paper, a short, but informative; (b) the first name, initials of middle name and last name of each author; (c) the institution; (d) the name of the department that is attributable to the scientific work; (e) the name and address of the author with whom to correspond about the manuscript (f) source/support in the form of grants, equipment, drugs, or all.

II. Second page - abstract and keywords: The abstract should be written with a maximum of 150 words for unstructured abstracts and 250 words for structured abstracts (containing parts: objective(s) of study or research, basic procedures, such as selection of subjects or laboratory animals, observational and analytical methods, then, the main findings/results (data and their statistical significance, if possible), and the main conclusions. Emphasize the new and important aspects of the study or observation.

Below the abstract identify and write the keywords: 35 words or short phrases that will assist in indexing the paper and publication of the abstract.

Use terms from the list of Index Medicus for Medical Sub-Headings (MeSH); if there is no appropriate MeSH term for some newly introduced terms, we can use the given terms.

III. Third and further pages – full text of the article: The full text of research or observational articles should normally be, but not necessarily, divided into sections with the following headings: introduction, material and methods, results and discussion.

1. Introduction: Provide a context or background for the study (that is, the nature of the problem and its significance). To do this you must complete a literature review – searching for, finding and reading relevant papers, which must be referenced in your manuscript. Explain your hypotheses and the plan to test them, and describe your aims. Clearly state what you expect to find and the reasoning that led you to the hypotheses that you have made. The research objective is often more sharply focused when stated as a question. Do not include data or conclusions from the work being reported.

2. Methods & Material: This section should include only information that was available at the time the plan or protocol for the study was being written. All information obtained during the study belongs in the Results section.

Describe your selection of the observational or experimental participants (patients or laboratory animals, including controls) clearly, including eligibility and exclusion criteria. The guiding principle should be clarity about how and why a study was done in a particular way.

Give sufficient details of the methods, apparatus and materials (give the manufacturer's name and address in parentheses), and procedures to allow others to understand and reproduce your results.

If a particular method used is well known then there is no need to give a complete description. You can reference the paper in

përmendni ndonjë modifikim/ndryshim që keni bërë. Jepni arsytet për përdorimin e tyre dhe vlerësoni kufizimet e tyre. Në fund, përshkruani se si i keni analizuar të dhënat tuaja, duke përfshirë metodat statistikore dhe pakon programore që keni përdorur.

Autorët e dorëshkrimeve të rishqyrtuara duhet të përfshijnë një paragraf që përshkruajnë metodat që kanë përdorur për lokalizimin, përzgjedhjen, ekstrahimin dhe sintetizimin e të dhënave. Përdorni formën joveprorë të foljes, në vetën e tretë, kur dokumentoni metodat, gjë që do të fokusonte vëmendjen e lexuesit tek puna që është bërë e jo tek hulumtuesi (P.sh. Janë marrë, janë realizuar, janë prezantuar etj.)

2. a) Statistikat: Përshkruani metodat statistikore me detaje të mjaftueshme për t'ia mundësuar një lexuesi me njohje në atë fushë t'i qaset të dhënave origjinale për të verifikuar rezultatet e raportuara. Kur është e mundur, përcaktoni sasinë e zbulimeve dhe prezantoni ato me indikatorë përkatës të gabimeve në matje apo pasiguri (siç janë inter-valet e besueshmërisë). Evitoni mbështetjen vetëm në testet statistikore të hipotezave, siç janë vlerat p, që dështojnë të transmetojnë informacion të rëndësishëm mbi madhësinë e efektit. Jepni detaje rreth përzgjedhjes së rasteve (randomizimi) dhe përshkruani metodat dhe sukseset e vrojtimit gjatë realizimit të studimeve të verbuara. Definoni termet statistikore, shkurtesat dhe më së shumti simbolet. Specifikoni programin kompjuterik që është përdorur.

3. Rezultatet: Ky paragraf duhet t'i bëjë gjetjet tuaja të qarta. Prezantoni rezultatet tuaja në rend logjik në tekst, tabela dhe ilustrime, duke dhënë së pari rezultatet kryesore ose më të rëndësishme. Mos i përsërisni të gjitha të dhënat në tabela apo ilustrime, në tekst. Nënvizoni ose përm-bledhni shkurtime vetëm vrojtimit më të rëndësishme.

Kur të dhënat përmblidhen në paragrafin e Rezultateve, jepni rezultate numerike jo vetëm si derivate (për shembull, përqindja) por gjithashtu si numra absolut nga të cilët derivatet janë llogaritur, dhe specifikoni metodat statistikore që janë përdorur për t'i analizuar ato.

Kufizoni tabelat dhe figurat në atë sa janë të nevojshme për të sqaruar argumentin e punimit dhe për të vlerësuar të dhënat ndihmëse. Duke përdorur grafikonet për të reprezentuar të dhënat tuaja si alternativë e tabelave, do të rrisë kuptueshmërinë e lexuesit. Mos i dyfishoni të dhënat në grafikone dhe tabela. Duhet të jeni të qartë se cili lloj i grafikoneve është i përshtatshëm për informacionet tuaja. Për shembull, për të reprezentuar korelimin mes dy ndryshoreve, preferohet grafiku vijëzor, krahasuar me grafikun rrethor apo në formë shtyllash.

Sa i përket të gjitha paragrafeve, qartësia dhe të qëniti i thuktë është kyç. Mos prezantoni të njëjtat të dhëna më shumë se një herë. Kufizojeni veten në të dhënat që ndihmojnë në adresimin e hipotezave tuaja. Kjo është e rëndësishme edhe nëse të dhënat i aprovojnë ose nuk i pranojnë ato. Nëse keni bërë analiza statistikore, duhet të jepni vlerën e probabilitetit (p) dhe të tregoni se është shprehës (sinjig në nivelin që ju po testoni. Varësisht nga analizat e përdorura, gjithashtu mund të jetë e rëndësishme të jepni intervalet e besueshmërisë së rezultateve (Confidence Interval –

which it was first described and mentioned any modifications you have made. Give the reasons for using them, and evaluate their limitations. Finally,, describe how you analysed your data, including the statistical methods and software package used.

Authors submitting review manuscripts should include a section describing the methods used for locating, selecting, extracting, and synthesizing data.

Use the third person passive voice when documenting methods which would focus the readers' attention on the work rather than the investigator.(e.g. Were taken, was performed, were presented itd.)

2. a) Statistics: Describe statistical methods with enough detail to enable a knowledgeable reader with access to the original data to verify the reported results. When possible, quantify findings and present them with appropriate indicators of measurement error or uncertainty (such as confidence intervals). Avoid relying solely on statistical hypothesis testing, such as p values, which fail to convey important information about effect size. Give details about the randomization and describe the methods and success of observations while using blinded trials. Define statistical terms, abbreviations, and most symbols. Specify the computer software used.

3. Results: This section should make your findings clear. Present your results in logical sequence in the text, tables, and illustrations, giving the main or most important findings first. Do not repeat all the data in the tables or illustrations in the text. Emphasize or summarize only the most important observations.

When data are summarized in the Results section, give numeric results not only as derivatives (for example, percentages) but also as the absolute numbers from which the derivatives were calculated, and specify the statistical methods used to analyze them.

Restrict tables and figures to those needed to explain the argument of the paper and to assess supporting data. Using graphs to represent your data as an alternative to tables will improve the reader's understanding. Do not duplicate data in graphs and tables. You need to be clear what type of graphs is suitable for your information. For example, to represent the correlation between two variables, a line graph is preferred to a pie chart or a bar chart.

As with all sections, clarity and conciseness is vital. Don't present the same data more than once. Restrict yourself to the data that helps to address your hypotheses. This is important whether the data supports or disproves them. If you have carried out a statistical analysis, you should give the probability (P) value and state it is significant at the level you are testing. Depending on the analysis used, it may also be important to give the confidence intervals of the results, or the statistical parameters such as the odds ratios. Provide a caption for each figure making the general meaning clear without reference to the main text, but don't discuss the results. Let the readers decide for themselves what they think of the data. Your chance to say what you think comes next, in the discussion.

3. Tables: Each table should be inserted at the point of the text where they have to be placed logically, typed by the same rules

CI), ose parametrat statistikore si proporcionet e rastit (odds ratio). Bëni përshkrimin tek secila figurë duke bërë të qartë domethënien e përgjithshme pa referencë në tekstin kryesorë, por mos diskutoni rezultatet në të. Lëreni lexuesin të vendosë vetë se çfarë men-don për të dhënat. Mundësia juaj për të thënë se çfarë mendoni, është në vazhdim, tek diskutimi.

3. Tabelat: Secila tabelë duhet të vendoset në vendin e tekstit ku duhet të vihet logjikisht, e plotësuar me të njëjtat rregulla sikur teksti i plotë. Mos i dërgoni tabelat si fotografi. Secila tabelë duhet të citohet në tekst. Tabelat duhet të jenë me numra ashtu që të jenë në koordinim me referencat e cituara në tekst. Shkruani një përshkrim të shkurtër të tabelës nën titullin. Çdo sqarim shtesë, legjendë ose sqarim i shkurtësuar jostandard, duhet të vendoset menjëherë poshtë tabelës.

4. Diskutimi: Ky paragraf është pjesa ku ju mund të interpretoni të dhënat tuaja dhe të diskutoni duke ballafaquar dhe krahasuar gjetjet tuaja me ato të hulumtuesve të mëparshëm. Rishikoni referencat e literaturës dhe shihni nëse mund të përfundoni se si të dhënat tuaja përkohë me atë që keni gjetur.

Ju gjithashtu duhet të llogarisni rezultatet, duke u fokusuar në mekanizmat në prapavij të vërtetimit. Diskutoni nëse rezultatet tuaja mbështesin hipotezat tuaja origjinale. Gjetjet negative janë aq të rëndësishme në zhvillimin e ideve të ardhshme sikur gjetjet pozitive.

E rëndësishme është se, nuk ka rezultate të këqija. Shkenca nuk të bëjë me të drejtën dhe të gabuarën, por merret me zgjerimin e njohjeve të reja.

Diskutoni si janë paraqitur gabimet në studimin tuaj dhe çfarë hapa keni ndërmarrë për të minimizuar ato, kështu duke treguar se ju çmoni ku-fizimet e punës tuaj dhe fuqinë e përfundimeve tuaja. Duhet gjithashtu të merrni në konsideratë ndërlikimet e gjetjeve për hulumtimet në të ardhmen dhe për praktikën klinike. Lidhni përfundimet me qëllimet e studimit, por evitoni qëndrimet dhe përfundimet e pakualifikuara, që nuk mbështeten në mënyrë adekuate nga të dhënat. Shmangni prioritetet deklarative apo të aludoni në punën që nuk është krahasuar.

5. Referencimi: Referencat janë baza mbi të cilën është ndërtuar raporti juaj. Shqyrtimi i literaturës dhe leximi i referencave gjithmonë duhet të jetë pikë fillestare e projektit tuaj. Ky paragraf duhet të jetë i saktë dhe të përfshijë të gjitha burimet e informacionit që keni përdorur.

Në formatin “Vancouver”, referencat numërohen një nga një, sikur që shfaqen në tekst dhe identifikohen me numra në bibliografi..

Shënoni të gjithë autorët kur janë gjashtë e më pak; kur janë shtatë ose më tepër, shënoni tre të parët, pastaj shtoni “et.al.” Pas emrave të autorëve shkruhet titulli i artikullit; emri i revistës i shkurtuar sipas mënyrës së Index Medicus; viti i botimit; numri i vëllimit; dhe numri i faqes së parë dhe të fundit.

Referencat e librave duhet të jepen sipas emrit të autorit, titulli i librit (mund të citohet edhe titulli i kapitullit para titullit), vendi i botimit, botuesi dhe viti.

as for the full text. Do not send tables as photographs. Each table should be cited in the text. Tables should be numbered so that they will be in sequence with references cited in the text. Provide a brief explanation of the table below the title. Any additional explanations, legends or explanations of non-standard abbreviations, should be placed immediately below the table.

4. Discussion: This section is where you interpret your data and discuss how your findings compare with those of previous researchers. Go over the references of your literature review and see if you can determine how your data fits with what you have found.

You also need to account for the results, focusing on the mechanisms behind the observation. Discuss whether or not your results support your original hypotheses. Negative findings are just as important to the development of future ideas as the positive ones.

Importantly, there are not bad results. Science is not about right or wrong but about the continuing development of knowledge.

Discuss how errors may have been introduced into your study and what steps you took to minimise them, thus showing that you appreciate the limitations of your work and the strength of your conclusions. You should also consider the implications of the findings for future research and for clinical practice. Link the conclusions with the goals of the study but avoid unqualified statements and conclusions not adequately supported by the data. Avoid claiming priority or alluding to work that has not been compared.

5. Referencing: The references are the foundation on which your report is built. Literature searches and reading of references should always be the starting point of your project. This section must be accurate and include all the sources of information you used.

In the Vancouver format, references are numbered consecutively as they appear in the text and are identified in the bibliography by numerals.

List all authors when there are six or fewer; when there are seven or more, list the first three, then add “et al.” The authors’ names are followed by the title of the article; the title of the journal abbreviated according to the style of Index Medicus; the year of publication; the volume number; and the first and last page numbers.

References to books should give the names of any editors, place of publication, editor, and year.

In the text, reference numbers are given in superscript. Notice that issue number is omitted if there is continuous pagination throughout a volume, there is space between volume number and page numbers, page numbers are in elided form (51-4 rather than 51-54) and the name of journal or book is in italics. The following is a sample reference:

Në tekst, numrat e referencave jepen me indeks të sipërm. Vëreni se çështja e numrave neglizhohet nëse ka numërtim të vazhdueshëm përgjatë gjithë vëllimit, ka hapësirë mes numrit të vëllimit dhe numrit të faqes, numrat e faqeve janë në këtë formë: 51-4 në vend të 51-54, dhe emri i revistës ose librit është në italic. Në vazhdim është një shembull i referencës:

Artikujt e revistave:

1. Lahita R, Kluger J, Drayer DE, Koffler D, Reidenberg MM. Antibodies to nuclear antigens in patients treated with procainamide or acetylprocainamide. *N Engl J Med* 1979;301:1382-5.
2. Nantulya V, Reich M. The neglected epidemic: road traffic injuries in developing countries. *BMJ* 2002;324: 1139.
3. Murray C, Lopez A. Alternative projections of mortality and disability by cause 1990-2020: global burden of disease study. *Lancet* 1997;349: 1498-504.

Librat dhe tekste tjera:

4. Colson JH, Tamour NJJ. Sports injuries and their treatment. 2nd ed. London: S. Paul, 2006.
5. Department of Health. *National service framework for coronary heart disease*. London: DoH, 2000.
www.doh.gov.uk/nsf/coronary.htm (accessed 6 Jun 2003).
6. Kamberi A, Kondili A, Goda A, dhe bp; *Udhërrëfyes i shkurtër i Shoqatës Shqiptare të Kardiologjisë për parandalimin e Sëmundjes Aterosklerotike Kardiovaskulare në praktikën klinike*, Tiranë, 2006
7. Azemi M, Shala M, dhe bp. *Pediatrica sociale dhe mbrojtja shëndetësore e fëmijëve dhe nënave*. Pediatra, Prishtinë 2010; 9-25

Shmangni përdorimin e abstrakteve si referenca; “të dhëna të papub-likuara” dhe “komunikime personale”. Referencat e pranueshme, por ende të papublikuara lejohet të merren, vetëm nëse shënoni se janë “në shtyp”.

6. Mirënjohjet: Ju mund të keni dëshirë të falënderoni njerëzit që ju kanë ndihmuar. Këto mund të rangohen prej atyre që ju kanë përkrahur me teknika eksperimentale deri tek ata që ju kanë këshilluar deri në bërjen e dorëshkrimit final.

7. Format i fajllit të të dhënave për ilustrimet (figurat): JPG

Nëse përdoren fotografitë e pacientëve, qoftë subjekti, qoftë fotografitë e tyre nuk duhet të jenë të identifikuar, ato duhet të shoqërohen me lejen e shkruar nga ta për përdorimin e figurës. Format e lejuara janë në dispozicion nga redaksia.

Nëse fajllat e të dhënave janë shumë të mëdha për t'u dërguar me e-mail, rekomandohet dërgimi me CD në adresën tonë.

8. Legjendat për Ilustrimet (Figurat)

Legjenda e tabelës duhet të vendoset mbi tabelë. Referenca e një tabeleje, e cila është marrë nga ndonjë publikim tjetër, duhet të vendoset poshtë tabelës. (Është përgjegjësi e autorit të sigurojë lejen e ribotimit nga botuesit e atij botimi) Legjenda e figurës duhet të vendoset në fund të faqes. Referenca e figurës e marrë nga ndonjë tjetër publikim vendoset në fund të legjendës. (Leja e ribotimit duhet të sigurohet nga botuesi i këtij botimi).

Journal articles:

1. Lahita R, Kluger J, Drayer DE, Koffler D, Reidenberg MM. Antibodies to nuclear antigens in patients treated with procainamide or acetylprocainamide. *N Engl J Med* 1979;301:1382-5.
2. Nantulya V, Reich M. The neglected epidemic: road traffic injuries in developing countries. *BMJ* 2002;324: 1139.
3. Murray C, Lopez A. Alternative projections of mortality and disability by cause 1990-2020: global burden of disease study. *Lancet* 1997;349: 1498-504.

Books and other monographs:

4. Colson JH, Tamour NJJ. Sports injuries and their treatment. 2nd ed. London: S. Paul, 2006.
5. Department of Health. *National service framework for coronary heart disease*. London: DoH, 2000.
www.doh.gov.uk/nsf/coronary.htm (accessed 6 Jun 2003).

6. Osler AG. *Complement: mechanisms and functions*. Englewood Cliffs: Prentice-Hall, 1976.

Avoid using as references abstracts; “unpublished data” and “personal communications”. References to accepted but yet unpublished articles are allowed to be made, only if you note “in press”.

6. Acknowledgements: You may wish to acknowledge people who have helped you. These can range from those who supported you with experimental techniques to those who read or offered advice on your final manuscript.

7. Data file format for illustrations (figures): JPG

If photographs of patients are used, either the subjects should not be identifiable or their pictures must be accompanied by written permission to use the figure. Permission forms are available from the Editor.

If data files are too big for transmission as an Email attachment submission of a CD to our address is recommended.

8. Legends for Illustrations (Figures)

The legend of a table has to be placed above the table. The reference of a table, which has been taken from another publication, must be placed below the table. (It is the author's responsibility to obtain the permission of reproduction from the publishers of the publication.) Figure legends are to be placed at the end of the paper. The reference of a figure taken from another publication stands at the end of the legend. (Permission of reproduction must be obtained from the publishers of this publication).

